| Lista e Anëtarëve                             | 62 |
| Shtojcë 2                                     |    |
| AmCham në Shtyp                               | 64 |
| Shtojcë 3                                     |    |
| Sponsor të AmCham në Aktivitete dhe Publikime | 66 |



## LETËR NGA PRESIDENTI

Të nderuar anëtarë,

Që nga Mbledhja e fundit e Asamblesë së Përgjithshme, ku ju zgjodhët një Bord të ri Drejtues, ne kemi punuar së bashku në një përpjekje të gjithanshme në AmCham, për të përmirësuar klimën e biznesit ku ju punoni dhe për ta bërë Shqipërinë më atraktive për bizneset e huaja. I gjithë programi i Dhomës Amerikane për 2012-ën ka patur në fokus interesat tuaja. Për t'i konkretizuar më mirë ato, ne hartuam një pyetësor ku ju kërkua të listoni çështjet me të cilat dëshironit që të merrej Dhoma. Çështjet e përzgjedhura prej jush kanë qenë prioriteti i punës së Dhomës Amerikane përgjatë gjithë vitit.

Duke dashur të krijojmë një organizatë me një strukturë solide, ne kemi implementuar shumë risi në qasjen tonë për përmirësimin e funksioneve dhe aktiviteteve të punës sonë, duke krijuar grupe pune permanente në katër komitetet e AmCham-it, të cilët hartojnë strategjitë e vogla të punës për t'i shërbyer më pas të gjithë komunitetit të AmCham-it.


Një tjetër novacion i rëndësishëm me fokus forcimin e procesit të lobimit, ishte krijimi i Forumit të CEO-ve. Drejtuesit më të lartë të bizneseve janë bashkuar dhe kanë marrë pjesë aktivisht në këtë Forum brenda Dhomës, ku diskutojnë dhe flasin për probleme dhe çështje të mprehta të industrive që përfaqësojnë dhe e orientojnë Bordin për rrugët më të mira në zgjidhjen e këtyre problematikave.

Si prurje të këtij Forumi dhe komiteve përkatëse kemi qenë insistent si Bord Drejtues për t'u takuar me të gjithë zyrtarët e lartë të qeverisë, me të cilët kemi folur hapur për problematikën që ka Dhoma. Në takimin me Kryeministrin Berisha, Forumi i CEO-ve adresoi qartë problematikat e disa industrive, duke i prezantuar ato dhe duke kërkuar zgjidhje nga drejtuesi më i lartë i qeverisë shqiptare.

Mendoj se 2012-a mund të quhet dhe një vit i përpjekjeve aktive dhe të vazhdueshme të lobimit, ku ne jemi përfshirë jo vetëm tek AmCham-i, por në bashkëpunim edhe me organizatat e tjera, në çështje të mprehta të klimës së biznesit në vend. Ne kemi folur hapur për çështje dhe problematika në procedurat tatimore, në funksionimin e Këshillave të Biznesit, ku ne jemi anëtarë aktivë, në hartimin dhe miratimin e ligjeve të reja dhe në dialogje konstruktive dhe të sqarta me ministri të ndryshme, duke identifikuar dhe lobuar për përmirësimin e klimës së biznesit, për ta bërë më konkurruese dhe të favorshme për kompanitë tona anëtare.

Kjo frymë e shpirtit luftarak për të mbrojtur interesat e anëtarëve është ajo që dallon Dhomen Amerikane të Tregtisë në Shqipëri nga organizatat e tjera dhe e bën AmCham-in një organizatë lider në treg. Ne të gjithë duhet të kujdesemi që ky shpirt të mbahet gjallë brenda Dhomës dhe t'i shërbejë objektivit themelor që kjo organizatë ka; përmirësimin e klimës së biznesit dhe rritjen e investimeve amerikane në vend.

Me respekt,



David Anderson  
President

## LETET NGA DREJTORJA EKZEKUTIVE

Të nderuar anëtarë,

Është kënaqësi që komunikoj me ju sërish nëpërmjet Raportit Vjetor, që është dhe botimi më i rëndësishëm i Dhomës Amerikane dhe dokumenti që sjell tek ju një vit aktivitet të kësaj organizate. Më lejoni t'ju sjell në vëmendjen tuaj përmes kësaj letre, momentet më të spikatura të Dhomës Amerikane gjatë 2012-ës.

Vitin e kaluar, Dhoma kaloi në një proces reformimi në të cilin ju keni luajtur një rol thelbësor. Falë votës suaj, në Asamblenë e Përgjithshme u përzgjedh një bordi i ri, i cili ka punuar me përkushtim dhe secili prej tyre ka sjellë në Dhomë eksperiencën e vet, që është orkestruar mjaft mirë në punën në grup dhe është udhëhequr me profesionalizëm nga presidenti i AmCham-it, z. David Anderson.

Bordi Drejtues ka bërë një punë të fokusuar në formatimin e statutit, miratimin përfundimtar të të cilit do ta jepni ju, një punë më të spikatur brenda komiteve dhe një frymë të re në këto struktura, që ka reflektuar në një lobim aktiv dhe të sukseshëm.

Viti që mbyllëm ka patur në fokus të vëmendjes së Dhomës Amerikane problematikat që ju keni sjellë në forumet tuaja të biznesit, në takimet e punës së komiteve apo dhe nëpërmjet pyetësorit. Një pjesë e tyre përputhen me Axiendën e Biznesit, me të cilën Dhoma Amerikane punon prej katër vjetësh duke na treguar ne se jemi duke punuar për çështjet e duhura.

Një punë të madhe gjatë vitit të kaluar kemi bërë dhe për çështjet e të Drejtës së Pronësisë Intelktuale. Shumë prej jush janë të shqetësuar për ndikimin negativ që ka mungesa e të drejtës intelektuale në vend dhe ne gjatë 2012-ës e kemi patur në fokus të punës së Komitetit të IPR-it. Në mbështetje të këtij objekti, kemi patur takime me zyrtarë të lartë duke e finalizuar me Konferencën Vjetore të IPR-it, që mbledhi Ambasadorët e BE-së dhe të Amerikës dhe disa zyrtarë të lartë të qeverisë shqiptare.


Panairi i Punës dhe konferenca që i paraprin, së bashku me trajnimin e punonjësve të rinj, ka shënuar edhe një tjetër histori në edicionet e Panairit të Punës, dhe sërish gjatë 2012-ës shumë prej jush besuan se ky aktivitet është i përshtatshëm për të testuar tregun e punës, por dhe për të sjellë një kontribut në të.

Si një tradicion i vjetër dhe ritual i Dhomës, festa e 4 Korrikut dhe ajo e Vitit të Ri, por këtë vit edhe Nata e Zgjedhjeve Amerikane kanë mbledhur të gjithë anëtarët, por dhe të ftuar të tjerë që janë bashkuar me ne për të festuar këto festa që vijnë mes aktiviteteve të tjera të Dhomës, si një moment relaksi dhe argëtimi.

Në përfundim, mund të them se 2012-a ishte një vit mjaft i rëndësishëm për Dhomën Amerikane dhe unë duhet të falenderoj anëtarët e AmCham-it për besimin dhe mbështetjen që i kanë dhënë kësaj organizate. Një falenderim i veçantë i shkon Bordit të AmCham-it dhe mbështetjes së Ambasadës Amerikane, e cila për vitin 2012 kishte një rëndësi të veçantë.

I uroj AmCham-it një vit të mbarë,

Me respekt,



Floreta Luli-Faber  
Drejtoresh Ekzekutive

## KODI I ETIKËS

Si një organizatë e dedikuar ndaj zhvillimit të biznesit, AmCham-i konsideron si një nga qëllimet e saj më të rëndësishme vendosjen e standarteve të larta të sjelljeve në biznes dhe parimeve të qytetarisë së mirë bashkëpunuese. Për këtë arsye AmCham-i

merr një rol drejtues dhe aktiv në nxitjen e standarteve dhe parimeve të biznesit, së pari duke adoptuar kodin e praktikave të biznesit, dhe së dyti, duke inkurajuar anëtarët e AmCham-it të vënë në zbatim kodin e praktikave të biznesit.

1. Anëtarët duhet të respektojnë legjislacionin dhe dispozitat përkatëse duke i qëndruar besnikë praktikave ligjore
2. Anëtarët duhet të respektojnë standartet më të larta të praktikave të biznesit në marrëdhënie me zyrat shtetërore
  - a. Anëtarët duhet të bien në konsensus përpara se t'i drejtohen zyrove shtetërore për një çështje të caktuar
  - b. Anëtarët duhet të jenë transparent në komunikimin e pozitave të Dhomës Amerikane të Tregtisë tek zyrat shtetërore
  - c. Anëtarët nuk duhet të përpiqen të influencojnë mbi zyrat shtetërore nëpërmjet dhënies së dhuratave, parave ose të informacioneve
3. Anëtarët duhet të përfshihen në biznese të ndershme
4. Anëtarët duhet të ndjekin politika të përgjegjshme për mjedisin
5. Anëtarët duhet të përfshihen në një drejtim/qeverisje të mirë qytetare
6. Anëtarët duhet të vendosin standarte të larta për:
  - a. Sjelljet e organizatës/kompanisë ndaj punonjësve
  - b. Sjelljet e punonjësve ndaj punonjësve
7. Anëtarët duhet të sigurojnë një vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm për punonjësit

## LOBINGU NË AMCHAM

Lobimi, një nga shtyllat më të rëndësishme të aktivitetit në AmCham ka përbërë dhe “zërin” më të fortë të anëtarëve të orkestruar nga Bordi Drejtues. Shqetësime të industrive, problematika biznesi, çështje parimore të krijimit të klimës optimale të të bërit biznes, kanë qenë elementë të lobimit në të cilën Dhoma Amerikane është përfshirë duke patur një strategji të qartë veprimi.

Eksperienca 13 vjecare e ndërthurur me një frymë të re të drejtimit të Dhomës ka bërë që për çdo çështje të ketë një strategji të qartë lobimi. Në çdo strategji të zbatuar, Dhoma ka shfaqur gjithë vëmendjen, këmbënguljen dhe përkushtimin e saj për të arritur qëllimin. Pikërisht kjo ka përbërë edhe ndryshimin në procesin e lobimit në krahasim me vitet e tjera. Dhoma jo vetëm i bën të njohura problematikat, por dhe i ndjek deri

në fund ato duke ofruar edhe zgjidhje ligjore dhe procedurale për problematikat që ngre.

Në çështjet e lobimit të Dhomës për 2012-ën, një vend të rëndësishëm ka zënë problematika e ngritur nga anëtarët mbi kontrollin e përsëritura tatimore dhe rimbursimin e TVSH-së. Këto dy çështje themelore kanë patur gjithë vëmendjen e strukturave të Dhomës, që në bashkëpunim me ekspertët e saj jo vetëm që ka trokitur në të gjitha instancat shtetërore, por dhe ka propozuar mbështetjen në ligj zgjidhjet e mundshme. Çështjet e procedurës tatimore nuk kanë qenë të vetmet që kanë tërhequr vëmendjen e Dhomës.

Kodi i punës dhe ndryshime të rëndësishme që rregullojnë marrëdhëniet punëmarrës-punëdhënës, kanë qenë në fokus të diskutimeve

në strukturat e Dhomës. Ligji i ri i TVSH-së dhe implementimi i tij, i cili mendohet se do të ketë ndikim të madh në jetën e biznesit, gjithashtu ka qenë një tematikë e rëndësishme lobimi.

Mes çështjeve që kërkonin lobim, Dhoma nuk ka lënë pas dore në 2012-ën edhe Gjykatën Administrative, për të cilën ka punuar në formë individuale por dhe në grup me organizatat e tjera të biznesit. Këshilli Konsultativ i Biznesit dhe forma e funksionimit të tij në shërbim të përmirësimit të klimës së biznesit, ka merituar gjithashtu vëmendjen e AmCham-it si një çështje me interes për lobimin.

### Çështjet tatimore të biznesit

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka përcjellë nëpërmjet disa aktiviteteve publike dhe të strukturave të



brendshme të Dhomës si dhe në takime me zyrtarë të lartë, shqetësimin e industrive të ndryshme

që bashkohen në një pikë të vetme dhe fajësojnë institucionin tatimor për një fushatë të egër tatimore, gjopa të larta të pajustificuara dhe kontrole abuzive që po çenojnë të ardhmen e biznesit të tyre. Një tjetër çështje e ngritur gjatë vitit të kaluar dhe e përcjellë në institucionet përkatëse ka qenë dhe problemi i vonesave në rimbursimin e TVSH-së. Për këto çështje, Dhoma ka shfaqur gjithë këmbënguljen e nevojshme për të folur dhe argumentuar përpara drejtuesve të institucioneve problematike dhe për të propozuar dhe zgjidhjet e mundshme.

Gjatë vitit 2012, janë dorëzuar pranë Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve një numër shqetësi mesh për zgjidhje, shqetësime që vinin nga të gjithë anëtarët dhe problematika me bazë industrish.

### Ligji i ri i TVSH-së

Dhoma Amerikane e Tregtisë përshëndeti hartimin e ligjit të ri të TVSH-së me asistencën e BE-së në përputhje me direktiven e 6të të BE-

së. Në të njëjtën kohë, Dhoma i kërkoi BE-së nëpërmjet një letre zyrtare që të ndikonte tek institucionet shqiptare për t'i dhënë institucionit tatimor, por dhe biznesit kohën e nevojshme për t'u njohur me ligjin.

Sipas Dhomës Amerikane të Tregtisë, aplikimi me urgjencë i këtij ligji do të ketë një impakt të gjerë në ekonominë e vendit. AmCham-i argumentoi në letrën e vet zyrtare se se ligji i ri për TVSH-në mund të bëhet një nga ligjet më të mira të hartuara me asistencën e BE-së në qoftë se komuniteti i biznesit do të përfshihet në diskutimin e tij dhe kërkesat që vijnë nga ky komunitet do të merren parasysh.

### Miratimi i Gjykatës Administrative

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka ngritur zërin sërish për të kërkuar miratimin dhe ngritjen me urgjencë të Gjykatës Administrative, si një format ligjor i nevojshëm për biznesin. Në këtë iniciativë Dhoma nuk ka qenë e vetme, por është përkrahur edhe nga shoqatat e tjera si Dhoma Britanike e Tregtisë dhe Industrisë në Shqipëri, Shoqata e Grave Profesioniste dhe Afariste të Shqipërisë, Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, Shoqata për Industrinë dhe Tregtinë Gjermane në Shqipëri dhe Shoqata Shqiptare e Bankave.

Ky grup organizatash të biznesit kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me vonesat e gjata në aprovimin e Ligjit të Gjykatës së Lartë, si një detyrim që mundëson zbatimin e ligjit për Gjykatën Administrative, dhe siguron një hap të rëndësishëm përpara në zbatimin e ligjit në Shqipëri. Komuniteti i biznesit u ka kërkuar me insistim të gjithë anëtarëve të Parlamentit Shqiptar të marrin në konsideratë diskutimin dhe aprovimin e Ligjit të Gjykatës së Lartë, pa shkaktuar vonesa të tjera.

### Ndryshimet në ligjin për funksionimin e Këshillit Konsultativ të Biznesit

Dhoma Amerikane e Tregtisë është anëtare e Këshillit Konsultativ të Biznesit që nga dita e parë e krijimit dhe ka qenë gjithnjë aktive me komente në këtë Këshill. Gjatë vitit të kaluar, duke prezantuar anëtarin e ri të Dhomës në këtë

Këshill, z. Bernard Shehu, Presidenti i Domës Amerikane, z. David Anderson, prezantoi dhe kërkesën e Dhomës për ndryshime themelore në Këshill, që i jepnin kësaj strukture më shumë bashkëpunim dhe legjitimitet me biznesin.

## KOMITETET NË AMCHAM

Në Dhomën Amerikane të Tregtisë aktualisht janë funksionale pesë komitete, të cilët janë aktivë dhe i japin një peshë të rëndësishme të gjithë aktivitetit të Dhomës Amerikane.

### Komiteti i Taksave dhe i Ligjeve

**Drejtuës z. Genc Boga - Boga & Associates**

Komiteti i Taksave dhe i Ligjeve, i cili gjatë vitit 2012 drejtohej nga z. Genc Boga, nga studio ligjore Boga & Associates, është një prej komiteteve



më aktiv në Dhomën Amerikane. Ky komitet ka si funksion informimin e vazhdueshëm të anëtarëve

në lidhje me ndryshime të rëndësishme të ligjeve që prekin biznesin, duke i dhënë mundësinë të dërgojnë sugjerime apo komente që ata kanë lidhur me këto ligje. Gjatë 2012-ës, ky komitet ka organizuar aktivitete me qëllime të ndryshme. Viti filloi me një aktivitet që u fokusua në diskutimin mbi tregun e shërbimeve bankare dhe aspekte të ndryshme të kontratave bankare, ku kanë qenë të ftuar përfaqësues nga bankat kryesore anëtare të AmCham-it. Por gjatë vitit, fokusi më i madh ka qenë në sjelljen e komenteve për ligje në diskutim, punë mbështetëse për takimet vjetore me Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve dhe Doganave, si dhe përmbledhje e komenteve ligjore të sjella nga anëtarët e AmCham-it.

### Komiteti i Burimeve Njerëzore

**Drejtuës z. Dritan Mezini - DM Consulting**

Komiteti i Burimeve Njerëzore (HR-it), i cili gjatë vitit 2012 drejtohej nga z. Dritan Mezini,

Dhoma kërkoi që me ligj në funksionimin e KKB-së të vendosej afati 60 ditor për shqyrtimin dhe komentimin e ligjeve dhe për prezantimin në publik, si një kusht i domosdoshëm i angazhimit të komunitetit të biznesit në hartimin e ligjeve nëpërmjet KKB-së.

nga DM Consulting ka funksionuar që në vitin e parë të AmCham.

Ky komitet mbledhet dhe diskuton mbi angazhimet dhe mbështetjen që Dhoma Amerikane mund ti japë tregut të punës. Ky komitet, kryesisht fokusohet në organizimin e Parairit të Punës dhe aktiviteteve rreth tij, por ka edhe dimensionet e tjera. Një nga takimet e Komitetit të HR-it ka qenë me ekspertë të Drejtorisë së Tatimeve dhe ka pasur si qëllim diskutimin rreth deklarimit elektronik të listëpagesave të punonjësve. Ky komitet është mbledhur edhe për të diskutuar mbi Kodin e ri të Punës, ndryshimet që ai po pëson dhe impakti që ka në tregun e punës. Konferenca për çështjet e tregut të punës, trajnimi "Si duhet të jenë të përgatitur për një intervistë pune forcat e reja të punës", si dhe vetë Panairi i Punës, dhe vazhdimet e këtij shër-bimi, kanë qenë si çdo vit pjesa kryesore në të cilën është fokusuar ky Komitet gjatë vitit 2012-të.



### Komiteti i të Drejtës së Pronësisë Intellektuale

**Drejtuës z. Arsen Kurti - Microsoft Albania**

Komiteti i të Drejtës së Pronësisë Intellektuale (IPR-it), gjatë vitit 2012-të drejtohej nga z. Arsen Kurti, nga Microsoft Albania dhe zëvendës presidenti i Dhomës Amerikane. Ky komitet ka bërë një punë mjaft të organizuar dhe të fokusuar në disa plane gjatë vitit 2012. Viti filloi me një punë të organizuar për të takuar të gjithë aktorët e tregut që ndikojnë tek mirefunksionimi i të drejtave





të pronësisë intelektuale në Shqipëri.

Në bashkëpunim me Rritje Albania, projekt i USAID-it në

Shqipëri, u bënë takime individuale në një numër institucionesh: Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Zyra Shqiptare e Patentave dhe Markave, Ministria Integritetit, Ministria Ekonomisë, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Autoriteti Konkurrencës, Inspektorati Qëndror, Ambasada Amerikane, Delegacioni Europian.

Këto takime mundësuan gjatë vitit në vijim organizimin e disa tryezave me të gjithë këto aktorë ku u mundësuan shumë diskutime për të parë dhe kuptuar problematikën e mos zbatimit të ligjeve për të drejtën e pronësisë intelektuale. Në nëntor të vitit 2012 është organizuar dhe konferenca e dytë për çështjet e IPR-it, me fokus mbrojtjen e pronësisë intelektuale, përafrimin e legjislacionit me BE-në, reforma institucionale dhe zbatimi i saj. Në këtë konferencë janë prezantuar nga kompani anëtare të Dhomes Amerikane, rastet konkrete të shkeljeve në fushën e IPR-it, kujt i drejtohen kompanitë për problematikat e tyre, humbjet ekonomike nga moszbatimi i ligjit dhe humbjet në buxhet nga të ardhurat nga taksat.

### Komiteti Aktiv i Grave në Biznes

**Drejtese zj. Nevila Dudaj - Century 21**

Komiteti Aktiv i Grave në Biznes (WoBAC), gjatë vitit 2012-të është drejtuar nga zj. Nevila Dudaj, nga Century 21 është një komitet i filluar në vitin 2009, i cili gjeti mbështetje në rrethin e grave të angazhuara në biznes dhe të anëtarësuar në Dhomën Amerikane. I fokusuar në zgjerimin e rrethit të grave që zotërojnë apo drejtojnë bizneset dhe në promovimin sa më të mirë të tyre, një



nga takimet interesante të vitit ishte organizimi i aktivitetit Mengjes për 8 Marsin, me pjesëmarrjen Ministres së Integritetit, zj. Majlinda Bregu, për të diskutuar mbi Rolin e Grave në Biznes në Procesin e Integritetit European të Shqipërisë. Me shumë interes është ndjekur nga WoBAC edhe takimi Mëngjes Pune me një nga kompanitë anëtare, Albania Duty Free Shops - Prestige Group, ku u bë i mundur prezantimi i kësaj kompanie, diskutimi i axhendës së këtij komiteti dhe përshendetja e Presidentit të AmCham, z. David Anderson. Viti u mbyll me një takim për prezantimin e drejtueses së rradhës të këtij komiteti, anëtares së bordit, zj. Flutura Veipi dhe diskutimin mbi planin e këtij komiteti për vitin 2013.

### Forumi i Drejtuesëve të Lartë Ekzekutivë Drejtues z. David Anderson, President në AmCham - AAC/ DAI

Forumi i Drejtuesëve të Lartë Ekzekutivë (CEO-

ve) është një nga iniciativat më të fundit të Dhomës Amerikane. Ky Forum, i cili e zyrtarizoi krijimin e tij në te-tor



të vitit 2012, është i përbërë nga një përfaqësues, drejtuesi më i lartë ekzekutiv, i anëtarëve presidencialë të AmCham, që janë dhe kompani lider të biznesit që operon në Shqipëri.

Forumi ka si qëllim angazhimin e nivelit më të lartë të qeverisë dhe të udhëheqësve shqiptarë në një dialog konstruktiv për të gjetur një zgjidhje për problemet ekonomike dhe sociale që lidhen me likuiditetin e biznesit, investimet dhe rritjen e punësimit. Që në muajt e parë të aktivitetit, takimet me Ambasadorin Amerikan dhe me Kryeministrin e Shqipërisë kanë treguar një angazhim serioz të këtij Forumi për të punuar në mbështetje të interesave të anëtarëve të AmCham dhe të gjithë komunitetit të biznesit në Shqipëri. Forumi i CEO-ve drejtohet nga Presidenti i AmCham, dhe që nga krijimi i tij, ka gjetur një mbështetje të veçantë nga zëvendës ambasadori amerikan në Shqipëri, z. Henry Jardine. Më

gjerësisht për këtë forum dhe punën në fushën e lobingut mund të lexoni në kapitullin 'Lobingu në AmCham'.

Sipas vendimit të Bordit të AmCham-it, që nga dhjetori i vitit 2012, komitetet operojnë sipas një mënyre të re, duke krijuar grupe permanente pune brenda çdo komiteti. Çdo grup permanent përbëhet nga drejtuesi i Komitetit dhe të paktën katër anëtarë permanent. Drejtuesit e Komiteteve zgjidhen nga Bordi Drejtues një herë në dy vjet. Drejtuesit e rinj të zgjedhur në nëntor dhe dhjetor të vitit 2012 janë:

Komiteti i Taksave dhe Ligjeve  
Drejtuese zj. Ardjana Shehi - Kalo & Associates  
Me 12 anëtarë permanent

Komiteti i Burimeve Njerëzore  
Drejtues z. Dritan Mezini - DM Consulting  
Me 4 anëtarë permanent

Komiteti i të Drejtës së Pronësisë Intelektuale  
Drejtues z. Arsen Kurti - Microsoft Albania  
Me 7 anëtarë permanent

Komiteti Aktiv i Grave në Biznes (WoBAC)  
Drejtuese zj. Flutura Veipi - ProCredit Bank  
Me 4 anëtarë permanent

## MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Dhoma Amerikane ka qenë aktive gjatë 2012-ës jo vetëm me aktivitete që i kanë shërbyer anëtarëve, por dhe me veprimtari që i kanë shërbyer publikut dhe kanë gjetur pasqyrim të gjerë në media. Gjatë këtij viti, janë shfrytëzuar të gjitha kanalet e komunikimit me anëtarët dhe publikun, duke filluar nga aktivitetet, dërgimi i infomacioneve *on-line*, mesazhet për të gjitha risitë ligjore dhe informative që ka patur Dhoma Amerikane e Tregtisë.

Shtypi dhe televizioni janë kanali komunikues mes Dhomës dhe publikut për të gjitha ato aktivitete të cilat Dhoma dëshiron t'i bëjë publike për vetë interesin e lartë që ka për to. Gjatë 2012-ës, Dhoma ka qenë e pranishme në shtypin e shkruar dhe atë elektronik për takime të rëndësishme me drejtues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave, Autoritetin e Konkurrencës, 4 korrikun, Konferencën e IPR-it, Zgjedhjet Presidenciale në Amerikë.

Angazhimin e saj në publik, Dhoma e shikon të lidhur ngushtë edhe me organizmat publikë ku ajo aderon. Duke dashur t'i shërbejë sa më mirë biznesit të saj anëtar, Dhoma është anëtare e Këshillit Konsultativ të Biznesit dhe anëtare e

Këshillit Tatimor. Në këto dy struktura Dhoma ka qenë aktive për të përcjellë mendimin e anëtarëve të saj në lidhje me ndryshime të rëndësishme ligjore, por që kanë dhe një ndikim të madh në klimën e biznesit në vend. Dhoma e ka shfrytëzuar aderimin në këto struktura për të sjellë një ndryshim cilësor në

jetën e biznesit në vend.

Jo vetëm kaq, por Dhoma Amerikane është edhe pjesë e rrjetit global të Dhomave Amerikane të Tregtisë me qendër në Uashington si edhe anëtare e AmCham-eve në Europë. Të gjitha këto aderime e ndihmojnë Dhomën të përcjellë imazhin dhe emrin e saj të mirë jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij.



## PUBLIKIMET

### Revista "The AmCham Advantage"

Revista "The Advantage" është botimi periodik i Dhomës Amerikane që shpërndahet pa pagesë tek anëtarët, shoqëria civile, institucionet shtetërore dhe ato diplomatike, si edhe tek organizatat ndërkombëtare në vend. Kjo revistë është konceptuar si një guidë informative për aktivitetet e Dhomës. Revista ka edhe rubrikën e lajmeve ekonomike, njësoj si në faqen e internetit. Anëtarëve të Dhomës Amerikane iu është bërë e mundur që të kenë seksione të veçanta, ku mund të publikojnë të dhëna mbi aktivitetin e tyre, zhvillimet e tyre të fundit ose edhe informacione që dëshirojnë t'i ndajnë me kolegët për të rejtat e aktivitetit të tyre. Këtë vit, revista përfshin edhe shumë të reja nga revista e Dhomës Amerikane në Uashington. Format i ri, artikujt shqip dhe anglisht në të njëjtën faqe, sjellin një pamje të re tërheqëse dhe bashkëkohore.

Dhoma Amerikane ka krijuar një rrjet të gjerë institucionesh, OJF-sh, organizatash ndërkombëtare dhe autoritete publike, ku ajo shpërndahet. Në të njëjtën kohë, revista "The Advantage" mund të gjendet në hotelet kryesore dhe në Aeroportin e Rinasit.

### Raporti Vjetor

Raporti Vjetor prezantohet në Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë të Dhomës Amerikane të Tregtisë. Ai përmban të gjitha aktivitetet që Dhoma ka kryer gjatë vitit. Raporti Vjetor përmban gjithë punën e kryer gjatë vitit nga Dhoma Amerikane, duke përfshirë aktivitetet e saj, aktivitetet e komiteteve, anëtarësinë, raportin financiar, Bordin Drejtues të Dhomës, marrëdhëniet me publikun dhe median. Ky publikim i shërben anëtarëve për t'u njohur me çdo aspekt të punës së Dhomës gjatë vitit. Ai përmban informacion të rëndësishëm për mënyrën se si janë administruar fondet dhe se si vepron kjo organizatë. Raporti Vjetor përfshin gjithashtu informacion mbi aktivitetet e zhvilluara gjatë një viti, fondet e shpenzuara atë vit, si edhe listën më të përditësuar të anëtarëve.

### Libri i Vitit

Viti 2009-2010 ka qenë viti i publikimit të edicionit të pestë të Librit të Vitit, që është edhe një nga botimet më serioze të Dhomës Amerikane. Ky botim

vjen me një seri faktesh dhe të dhënash ekonomike dhe përmbledh shifra të rifreskuara makroekonomike, adresat e institucioneve qeveritare, ministri dhe trupit diplomatik. Libri i Vitit përfaqëson këndvështrimin e Ambasadës Amerikane për ekonominë shqiptare si dhe përmban një departament të posaçëm të "Guidës së Biznesit", që është një vështrim i përgjithshëm mbi ekonominë, të dhënat më të fundit makro, mënyrën se si bëhet biznes në vend dhe një vështrim i përgjithshëm mbi tregjet kryesore në vend.

Ky botim, mund të konsiderohet si një nga botimet më të sukseshme dhe më të kërkuara të Dhomës Amerikane për vetë seriozitetin dhe rëndësinë që ka në tregun vendas, por edhe në atë të huaj. Dhoma Amerikane merr masa për ta shpërndarë këtë libër tek anëtarët, institucionet publike, parlamenti, organizatat shqiptare dhe të huaja, në organizata në Amerikë, në AmCham-et në Europë dhe në Amerikë, në konferenca e aktivitete në vend e ndërkombëtare, duke e bërë të njohur ekonominë shqiptare dhe mundësinë për investime në vend. Botimi i gjashtë do jetë Libri i Vitit 2014-2015.

### AmCham në internet

Faqja e internetit e Dhomës Amerikane [www.amcham.com.al](http://www.amcham.com.al) pasqyron një informacionin të parë për mënyrën se si bëhet biznes në Shqipëri. Ajo është e përditësuar mbi aktivitetet e përditshme të Dhomës dhe mbi aktivitetet që do të organizohen në të ardhmen. Anëtarët dhe joanëtarët mund të marrin informacion të përditësuar në lidhje me paketat ligjore të projektligjeve në diskutim, mes grupeve të interesit dhe përfaqësuesve të qeverisë.

Projektligje shumë të rëndësishme iu janë paraqitur anëtarëve përmes kësaj faqe interneti, për diskutime dhe komente, dhe Dhoma i ka përcjellë këto komente tek grupet respektive të punës, të ngritura për këto projektligje. Kjo faqe interneti është përdorur me sukses si mjet komunikimi edhe për aplikantët e Panairit të Punës të Dhomës. Gjithashtu, kjo faqe interneti përmban informacion të detajuar mbi kriteret që duhet të plotësojë biznesi për t'u bërë anëtar i Dhomës Amerikane të Tregtisë, strukturën organizative të Dhomës, Bordin Drejtues dhe stafin e saj.

Duke e parë si një mjet të fuqishëm komunikimi, faqa e internetit të AmCham do riformatohet dhe do dalë me një version të ri gjatë vitit 2013.

## ANËTARËSIA

Qëndrueshmëria dhe kualiteti i çdo organizate varet nga anëtarët e saj. Dhoma Amerikane ka demonstruar më së miri se udhëhiqet nga kjo filozofi dhe se qëllimi i saj kryesor është mbështetja dhe zhvillimi i bizneseve të saj anëtare. Edhe në 2012-ën AmCham-i ka ruajtur të njëjtin nivel anëtarësie me atë të një viti më parë dhe bizneset kanë treguar interesin e lartë për të qenë pjesë e një prej organizatave më prestigjioze dhe më me emër të biznesit në vend.

Procesi i rinovimit të anëtarësimit për të gjithë anëtarët mundëson ofrimin e një shërbimi më të mirë për ta, që është pikërisht mbrojtja e interesave të anëtarëve në çdo aspekt të punës së biznesit, që nga niveli i taksave dhe deri tek çështjet administrative dhe burokratike. Nga ana e saj, Dhoma Amerikane është munduar të justifikojë besimin e anëtarëve të saj, duke qenë mjaft aktive në fushën e lobingut. Për të kryer me sukses këtë mision, këtë vit Dhoma e ka sintetizuar punën nëpërmjet komiteteve dhe grupeve të tyre permanente, të cilët e kanë ndihmuar organizatën për të patur një strukturë më solide dhe të ndarë në objektiva të të gjithë veprimtarisë së saj.

Gjatë vitit 2012, Dhoma Amerikane ka patur 211 anëtarë, nga të cilët 205 anëtarë legjitim dhe me të drejtë vote dhe 6 anëtarë nderi. Shkalla e anëtarësimit ka qenë e njëjtë si në 2011-ën. Këtë vit vëmë re një rritje të lehtë të të ardhurave nga anëtarësia në krahasim me vitin e kaluar. Të ardhurat nga anëtarësia gjatë vitit 2012 zinin 61.4 përqind të të ardhurave gjithsej, krahasuar me 59.3 përqind të të njëjtit tregues në vitin 2011.


Në vitin 2012 AmCham-i kishte 77 anëtarë presidencialë. Është për t'u theksuar se nga viti në vit ka një tendencë në rritje të Anëtarëve Presidencialë dhe mes anëtarëve ekzistues, një numër i konsiderueshëm biznesesh kanë preferuar që të jenë pjesë e kësaj kategorie. Për të rritur cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve dhe për t'i

ofruar shërbime shtesë kategorisë së Anëtarëve Presidencialë, në 2012-ën u krijua një strukturë e re brenda AmCham-it, ajo e Forumit të Drejtuesve të Lartë Ekzekutivë (Forumi i CEO-ve), e cila ka qenë pjesë aktive e lobimit të organizatës për çështje të rëndësishme të biznesit.

### Kategoritë e Anëtarësisë:

|    |                       |
|----|-----------------------|
| 77 | Anëtarë Presidencialë |
| 85 | Kompani               |
| 30 | Biznese të Vogla      |
| 13 | OJQ dhe Individë      |
| 6  | Anëtarë Nderi         |

Struktura e anëtarësisë së Dhomës Amerikane të Tregtisë për vitin 2012 është siç tregohet në **Diagramën 1**.



Megjithë problematikat që po has biznesi dhe situatës jo të favorshme ekonomike, edhe gjatë vitit 2012, AmCham-i është përpjekur shumë për të ruajtur të njëjtin nivel anëtarësie. Kjo tregon edhe njëherë se cilësia e shërbimeve të ofruara dhe dialogu konstruktiv që AmCham ka patur me institucionet qeveritare për çështje dhe fenomene shqetësuese që ndikojnë në zhvillimin e biznesit të anëtarëve, ka bërë të mundur që edhe këtë vit shumica e tyre të vazhdojnë të qëndrojnë me Dhomën Amerikane.



## RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2012

Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham) në Shqipëri, është një organizatë biznesi private, e krijuar për t'i shërbyer anëtarëve të saj dhe komunitetit të biznesit në Shqipëri. Për krijimin e të ardhurave të saj, AmCham-i mbështetet kryesisht në kuotat e anëtarësisë, shërbimet e ofruara për anëtarët, sponsorizimet nga organizatat e tjera vendase dhe të huaja, sipas aprovimit të Bordit. Sipas statutit të Dhomës, AmCham-i nuk pranon fonde nga qeveritë e asnjë shteti apo nga organizatat politike.

Shpenzimet e Dhomës përfshijnë kostot administrative që shërbejnë për menaxhimin e organizatës, shpenzimet për organizimin dhe menaxhimin e mëngjesëve dhe drekave të punës, forumeve të biznesit, panairin e punës, si dhe kostot për përgatitjen e publikimeve.

Viti 2012 ishte specifik për AmCham-in. Buxheti u aprovua pothuajse në mes të vitit. Por fokusi ishte si gjithmonë që në fund të vitit organizata të kishte në bankë jo më pak mjete financiare se sa në fillim të vitit. *Situata financiare prezantohet dhe aprovohet nga Bordi i AmCham-it çdo mbledhje përgjatë vitit.*

Kur Bordi diskutonte buxhetin vjetor të Dhomës, u hodhën për diskutim edhe një sërë çështjesh që ishin akoma të paqarta për kohën. Parashikimet financiare nuk ishin kaq të lehta për t'u realizuar. Viti kishte një fillim të ngadaltë. Në mënyrë që të vazhdonim rritjen e standardeve në AmCham, duhet të vazhdohej me punën e mirë, duhet të ruhej niveli i anëtarësisë dhe duhet të ishim të kujdesshëm me shpenzimet.

Bordi rishikoi të gjitha rregulloret financiare. Të ardhurat dhe shpenzimet e Dhomës Amerikane për periudhën 2010-2012 janë paraqitur në **Tabelën 1**, tabelë e cila tregon edhe se AmCham-i ka punuar shumë për të përmbushur objektivat e veta, që të fillonte ngritja nga ana financiare dhe të ngrihej numri i anëtarëve.

Ecuria financiare e Dhomës tregon se elementet e shpenzimeve dhe të ardhurave kanë në përgjithësi tendenca pak më të ndryshme

### TE ARDHURA - SHPENZIME, 31 dhjetor 2012

Shifrat në Lekë

Tabela 1

| Viti                        | 2010              | 2011              | 2012              |
|-----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Diferencë e mbartur         | <b>13,938,338</b> | <b>15,593,832</b> | <b>14,839,333</b> |
| Të ardhurat                 | 30,024,893        | 21,407,744        | 21,231,459        |
| Anëtarësia                  | 16,587,441        | 12,696,448        | 13,041,869        |
| Mbështetje jo-anëtarë       | 772,317           | 136,046           | -                 |
| Shërbime për anëtarë        | 6,896,543         | 8,147,518         | 7,463,132         |
| Publikime                   | 1,258,123         | 260,307           | 244,656           |
| Projekte                    | 4,171,350         | -                 | -                 |
| Investime                   | 149,872           | 167,425           | 165,236           |
| Të tjera                    | 189,248           | -                 | 316,566           |
| TVSH                        | 772,973           | -                 | -                 |
| Shpenzimet                  | <b>28,465,218</b> | <b>21,975,899</b> | <b>20,566,971</b> |
| Pajisje                     | 1,101,782         | 700,924           | 405,652           |
| Personeli                   | 8,370,167         | 8,392,279         | 7,784,563         |
| Administrimi                | 9,072,841         | 7,041,217         | 6,124,886         |
| Shërbime                    | 4,686,974         | 4,132,721         | 4,374,455         |
| Publikime                   | 3,629,574         | 1,708,759         | 1,563,216         |
| Projekte                    | 1,603,880         | -                 | -                 |
| Të tjera                    | -                 | -                 | 314,199           |
| TVSH                        | 706,763           | 183,932           | 333,987           |
| Investimet                  | <b>5,425,047</b>  | <b>5,595,396</b>  | <b>5,772,988</b>  |
| Llogari depozite USD        | -                 | -                 | -                 |
| Llogari depozite Euro       | 2,536,052         | 2,580,509         | 2,629,605         |
| Llogari depozite Lekë       | 2,888,994         | 3,014,886         | 3,143,383         |
| Para në Bankë               | <b>10,168,786</b> | <b>9,243,938</b>  | <b>9,402,087</b>  |
| Llogari në USD              | 204,608           | 177,770           | 560,083           |
| Llogari në Euro             | 1,712,522         | 2,040,944         | 2,668,732         |
| Llogari në Leke             | 8,251,656         | 7,025,223         | 6,173,272         |
| Para në dorë                | -                 | -                 | -                 |
| Efekti i kursit të këmbimit | <b>29,608</b>     | <b>(2,411)</b>    | <b>5,240</b>      |
| Bilanci në Mbyllje          | <b>15,593,832</b> | <b>14,839,333</b> | <b>15,175,075</b> |



nga vitet e mëparshme. Pjesa më e madhe e të ardhurave vjetore të AmCham-it, si çdo vit, vjen nga **kuotat e anëtarësisë**. Gjatë vitit 2012, të ardhurat nga anëtarësimet përbëjnë 61.43 përqind të të ardhurave të vitit, pra shifër më e lartë në krahasim me 59.31 përqind të këtij treguesi në vitin 2011. Ky është niveli mesatar i të ardhurave nga anëtarësia në këto pesë vitet e fundit, me përjashtim të 2007-ës, kur ky nivel ka qenë në masën 65.5 përqind. Por, është shumë pozitive fakti që të ardhurat në këtë kategori janë rritur me 2.7 përqind duke treguar rritje, megjithëse ishte një vit i vështirë dhe pat një numër në rritje të anëtarëve të cilët nuk u rianëtarësuan për arsye të vështirësive financiare në bizneset e tyre.


Duke filluar nga viti 2006, të ardhurat nga sponsorizimet e anëtarëve si dhe të ardhurat nga aktivitetet ku pjesëmarrja e anëtarëve është me pagesë, janë prezantuar në të njëjtën kategori, në atë të të ardhurave nga **shërbimet**. AmCham-i ka ruajtur dhe përmirësuar cilësinë e aktiviteteve, pasqyrimin në media dhe përfshirjen në këto aktivitete të një numri më të madh biznesesh, duke rritur kështu interesimin e anëtarëve në sponsorizimin e aktiviteteve të ndryshme. Gjatë vitit 2012, AmCham-i ka pasur edhe një rritje të sponsorizimeve me produkte. Në 2012-ën, AmCham-i ka një rënie të të ardhurave të kësaj kategorie, por me një mbulim direkt të koston për shërbimet në masën 170.6 përqind. Kategoria e të ardhurave nga shërbimet përbën 35.15 përqind të totalit të të ardhurave të Dhomës, ndërsa shpenzimet për shërbime përbëjnë 21.27 përqind të totalit të shpenzimeve.

Viti nuk kishte të ardhura në kategorinë **projekte** për vitin 2012-të. Kjo organizatë ka punuar rrallë me projekte gjatë viteve të fundit, ndërsa mendohet se kapaciteti i rritur i AmCham-it lejon për më shumë projekte në shërbim të anëtarëve.

Një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave të AmCham-it duhet të vijë nga **publikimet**. Megjithëse është një nga shërbimet ndaj anëtarëve të Dhomës, kjo kategori është ndarë më vete për të treguar potencialin apo dobësitë e kësaj kategorie nga ana financiare. Gjatë vitit 2012, të ardhurat në këtë kategori u ulën në mënyrë të ndjeshme. AmCham-i nuk publikoi një edicionin të ri të Librit të Vitit, ndërsa edicioni tjetër vjen për vitet

2014-2015. Të ardhurat për reklama tek revista *The Advantage* gjithashtu kanë pësuar një rënie. Një analizë e mëtejshme e të ardhurave nga publikimet tregon se vetëm 15.65 përqind e koston së revistës mbulohet nga të ardhurat e reklamave, ndërsa pjesa tjetër mbështetet nga vetë AmCham-i. Ndërsa ulja e shpenzimeve totale për revistën ka ardhur si rezultat i publikimit të më pak revistave gjatë vitit.


Në 2012-tën, të ardhurat nga investimet ishin 165,236 Leke. Shumat në depozita janë rritur me të ardhurat nga interesat e depozitave gjatë vitit, por totali i të ardhurave nga depozitat gjatë vitit është ulur në krahasim me një vit më parë për arsye të interesave më të ulta të zbatuara nga bankat. Të ardhurat në këtë kategori janë vetëm 0.78 përqind




të totalit të të ardhurave vjetore, e njëjtë me një vit më parë, siç tregohet në **Diagramën 2**.

Të ardhurat nga anëtarësia gjatë 2011-ës kanë rënë me 23 përqind në krahasim me 2010-ën. Ndërsa ato kanë pësuar një rritje prej 2.7 përqind në krahasim me një vit më parë. AmCham-i është i fokusuar për më shumë të ardhura nga anëtarësia, për të mbajtur dhe për të rritur numrin e anëtarëve, duke besuar se shërbimet që ju ofrohen anëtarëve i shërbejnë një numri më të madh biznesesh që operojnë në Shqipëri.

Gjatë vitit 2012, AmCham-i shpenzoi 98 përqind të parave të fituara gjatë një viti, nga një xhiro vjetore prej 21.23 milion Lekësh, që është në linjë me të njëjtin raport me vitet e kaluara. Struktura e të ardhurave të AmCham-it gjatë 2012-ës, paraqitet në **Diagramën 3**.



AmCham-i vazhdon t'i paraqesë llogaritë mbi bazën e cash-it. Struktura e shpenzimeve të AmCham-it gjatë vitit 2012-të tregohet në **Diagramën 4**.




Shpenzimet për personelin dhe stafin e përhershëm gjatë vitit 2012-të janë ulur në krahasim me një vit më parë me 8.5 përqind. Kjo ulje u ndikua nga një ulje e numrit të personelit dhe dy leje lindje të marra gjatë vitit. Megjithatë, këto shpenzime janë në nivelin 36 përqind të totalit të shpenzimeve krahasuar me 37 përqind të këtij treguesi për 2011-tën. Shifrat tregojnë një ulje të kostove të kategorisë së

administrimit me 11.5 përqind krahasuar me vitin e mëparshëm. Kjo ulje është pozitive, megjithëse një vit më parë ky tregues pat një zbritje në masën 20 përqind. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se në 2012-ën kostot administrative ishin në masën 29.79 përqind ndaj shpenzimeve të përgjithshme, që tregon një ulje në krahasim me 32.04 përqind të këtij treguesi për vitin 2011, dhe 31.87 përqind të këtij treguesi për 2010-ën.

Njësoj si tek të ardhurat, shpenzimet për publikimet janë të analizuara më vete nga shërbimet e tjera të Dhomës, dhe janë të analizuara më sipër, së bashku me të ardhurat në kategoritë respektive. Kjo kategori shpenzimesh përbën 7.6 përqind të totalit të shpenzimeve në 2012-ën, krahasuar me 7.8 përqind të totalit të shpenzimeve në 2011-ën dhe me 12.7 përqind të këtij treguesi në 2010-ën.

**Diagrama 5** tregon ndryshimet në strukturën e shpenzimeve të Dhomës në tre vitet e fundit.



## PROGRAME DHE NGJARJE

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri sapo kaloi një vit të ngarkuar dhe mjaft interesant, të mbushur me aktivitete dhe përpjekje lobuese në emër të anëtarëve. Gjatë vitit 2012, AmCham-i organizoi mbi 50 funksione në emër të anëtarëve të saj dhe publikut.

Fillimi i vitit 2012 ishte me i fokusuar tek puna me Komitetet e Dhomës, të cilat patën mjaft interes dhe një pjesëmarrje të lartë nga anëtarët.

Pas Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë në muajin prill, dhe me zgjedhjen e Bordit të ri, fokusi u drejtua tek puna lobuese dhe nevojat e anëtarëve të AmCham, tek Axhenda e Biznesit dhe adresimi i çështjeve të anëtarëve në nivelet më të larta të qeverisë dhe administratës. Këto aktivitete kanë rritur në mënyrë të ndjeshme nivelin e shërbimeve për anëtarët. Ato kanë shërbyer edhe për të rritur dhe forcuar AmCham-in në Shqipëri dhe për të rritur prestigjin e saj në vend.

## KALENDARI I AKTIVITETEVE TË AMCHAM 2012

### 8 janar, Aktivitet i Komitetit të Taksave dhe Ligjeve me bankat

Marrëdhëniet e biznesit me bankat.

Komiteti i Taksave dhe i Ligjeve ka organizuar një takim me përfaqësues të bankave dhe të biznesit të vet anëtar.



Dualiteti i marrëdhënieve biznes-bankë ashtu siç ka benefitetet ka edhe problemet dhe risqet e veta. Bizneset i drejtohen bankave për të siguruar financime për aktivitetin e tyre privat dhe bankat presin që të marrin mbrapsh paratë e dhëna dhe interesat. Por gjatë këtij procesi, ka një shkëmbim të vazhdueshëm informacioni mes bankave dhe mbi të gjitha kosto që jo gjithmonë i bëhen të ditura klientit. Gjatë takimit, është folur mbi rregulloren e re të Bankës së Shqipërisë, që i jep të drejtën klientit të informohet në mënyrë të plotë nga bankat kur vendos të negociojë me to për një kredi apo produkt të tyre. Në takim, kanë dalë në pah edhe problemet që bankat hasin gjatë kohës së informimit të klientëve të tyre, siç është ai i adresave.

### 8 mars, WoBAC, Mëngjes Pune me Ministren Bregu



Me rastin e Ditës së Gruas, Dhoma Amerikane e Tregtisë organizoi në Hotel Sheraton një Mëngjes Pune, ku e ftuar nderi ishte Ministria e Integritimit, Majlinda Bregu. Pjesë e takimit ishin edhe Zëvendësministria e Integritimit, Grida Duma, Drejtorja e AIDA-s, Eneida Guria dhe gra të tjera nga administrata, organizatat ndërkombëtare në Tiranë dhe anëtarët e Komitetit Aktiv të Grave në Biznes që funksionon pranë Dhomës Amerikane.

Takimi ishte i fokusuar tek roli i grave në biznes dhe kontributet e tyre në procesin e integritimit europian

të Shqipërisë. Në fjalën e saj të hapjes së takimit, Floreta Luli-Faber, Drejtore Ekzekutive e Dhomës Amerikane të Tregtisë, tha se takimi që mbahet në një ditë të veçantë, Ditën e Gruas ka simbolikën e tij, dhe tregon se zëri i grave si në çdo fushë tjetër ka hapësirën e tij edhe në biznes. “Gratë tashmë ia kanë dalë të kenë sipërmarrjet e tyre, të jenë të sukseshme në politikë, të jenë administratore të zonjat dhe besoj se ne të gjitha duhet të ndjehemi mirë me këtë. E vërteta e dukshme sot është që gratë kanë arritur shumë, dhe ju jeni shembulli për këtë”, është shprehur Znj. Bregu.

### 13 mars, Aktivitet i Komitetit të HR-it me Drejtorin e Tatimeve

Forum Biznesi për Listëpagesat Elektronike me Drejtorin e Tatimeve Priifti. Dhoma Amerikane e Tregtisë organizoi me 13 mars në Hotel Sheraton një takim me ekspertë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të diskutuar rreth deklarimit elektronik të listëpagesave të punonjësve. Takimi u ndoq me shumë interes nga përfaqësues të zyrave, financierë të bizneseve anëtare të AmCham-it. Për pjesëmarrësit ka dhënë shpjegime rreth kërkesës së paraqitjes elektronike të listave të punonjësve, Drejtori i Shërbimit të Tatimpaguesve në DPT, Erion Priifti. Nga tatimet kishte edhe ekspertë të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit. Pas prezantimit të të ftuarve nga tatimet dhe biznesi nga Drejtoria Ekzekutive e AmCham-it, Floreta Luli-Faber, Drejtori i Shërbimit të Tatimpaguesve në DPT ka bërë një shpjegim për kërkesën dhe procedurat e plotësimit të listëpagesave elektronike.



21 mars, Aktivitet i Komitetit të IPR-it me Autoritetin e Konkurrencës

### 21 mars, Aktivitet i Komitetit të IPR-it me Autoritetin e Konkurrencës

Dhoma Amerikane e Tregtisë organizoi një takim mes drejtuesve më të lartë të Autoritetit të Konkurrencës dhe anëtarëve të saj. Takimi është mbajtur në Hotel Sheraton dhe është ndjekur me shumë interes nga të pranishmit. Në hapjet e tij, Arsen





Kurti, Kryetar i Komitetit të IPR-it në AmCham tha se u mendua organizimi i këtij takimi, duke parë

problemet e shumta që kanë bizneset në treg me konkurrencën. Takimi është pjesë e një serie takimesh të ngjashme që Dhoma Amerikane organizon me drejtuesit e lartë të institucioneve. Z. Kurti shpjegoi se takimi synon që të gjithë bizneset anëtare të AmCham të adresojnë shqetësimet e tyre, duke i shërbyer kështu qëllimit që ka Dhoma për të lehtësuar punën dhe për të zgjidhur problemet që mund të kenë anëtarët e saj. Znj. Lindita Milo (Lati), Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës, e cila në takim shoqërohej nga drejtuesit më të lartë të institucionit, ka bërë një sqarim për të gjithë të pranishmit të Ligjit të Konkurrencës dhe të mënyrës së funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës.

### Mars, Takimi i AmCham-eve të Europës në Bruksel

Përfaqësues të Dhomave Amerikane nga e gjithë Europa janë bashkuar në takimin vjetor në Bruksel, ku



është folur gjerësisht edhe për rolin që mund të luajë biznesi në marrëdhëniet transatlantike. Konferenca për marrëdhëniet transatlantike ka qenë dhe pjesa më e rëndësishme e këtij takimi vjetor, i cili është shoqëruar dhe nga takime të tjera të nivelit të lartë. Në konferencë kanë marrë pjesë Komisioneri Europian për Tregtinë, Kreu i Delegacionit të EU-së në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Konferenca e nivelit të lartë ka mbledhur së bashku politikëbërës, drejtues biznesesh, akademikë nga Europa dhe Shtetet e Bashkuara, për të diskutuar mbi zhvillimin e Axshendës së Transatlantikut, për sfidat dhe mundësitë e përbashkëta ekonomike që sjell kjo axhendë. Në takim, ka marrë pjesë me përfaqësuesen e vet edhe Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri. Drejtorja Ekzekutive, Floreta Luli-Faber, ka qenë gjithashtu prezente në një seri

të rëndësishme takimesh që janë organizuar nga AmCham EU me këtë rast.

### Mars, Drejtorja e Dhomës Amerikane takohet me Ambasadorin Maqedonas në Shqipëri

Marrëdhëniet e zhvilluara të biznesit me Maqedoninë dhe interesi që firmat maqedonase kanë për tregun shqiptar, ka sjellë me iniciativën e tij në një takim me Dhomën Amerikane, Ambasadorin



e Maqedonisë në Shqipëri, z. Vele Tërpevski. Gjatë takimit, është folur për mundësitë e mëdha të bashkëpunimit të Dhomës Amerikane dhe anëtarëve të saj me biznesin maqedonas në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Ambasadori maqedonas i ka kërkuar Znj. Faber që për kërkesa specifike që bizneset maqedonase kanë për tregun shqiptar, t'i adresojë tek anëtarët e saj, duke ndihmuar kështu në zhvillimin e një marrëdhënieje bashkëpunimi mes bizneseve të dy vendeve.

### 12 prill, Zgjedhjet e Përgjithshme të Asamblesë

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka nxjerrë përmes Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë Bordin e



ri drejtues të organizatës. Nga votimi i pjesës dërrmuese të anëtarëve, kjo organizatë ka përzgjedhur Presidetin, Zëvendëspresidentin, Sekretarin dhe Përgjegjësin e Thesarit si edhe shtatë anëtarë të bordit drejtues. Bien në sy emra të mëdhej të biznesit në Shqipëri dhe kompani të njohura amerikane që janë bërë nëpërmjet këtij procesi transparent votimi, pjesë e bordit që do të drejtojë Dhomën Amerikane gjatë dy viteve në vijim. Mbledhja është drejtuar nga anëtarë më i vjetër i Dhomës Amerikane si edhe Presidenti i parë i saj, një prej pesë anëtarëve themelues, z. Krenar Loloçi, i cili ka përshëndetur anëtarët.

### 25 prill, Konferenca për Çështjet e Tregut të Punës

Dhoma Amerikane ka organizuar një ditë përpara

Panairit të Punës Konferencën me tematikë “Çështjet e tregut të Punës”. Siç është bërë traditë vitet e fundit, Panairit të Punës i paraprin Konferenca e Panairit, e cila fokusohet gjithnjë në një tematikë të caktuar. Këtë vit, tema e Konferencës ka qenë Kodi i ri i Punës, ndryshimet që ai po pëson dhe impakti që ka në tregun e punës. Përfaqësuesi i Ministrisë së Punës, z.Vasil Dodi, ka folur gjatë mbi ndryshimet që po pëson kodi, duke përmendur një pjesë të rëndësishme të tyre. Kështu, përcaktimi në kod i ditëve të pushimit që përkohet e dielë, ndryshime mbi lejen e lindjes apo përcaktimi i barrës së provës për çështje që shkojnë në gjyq, janë disa nga ndryshimet e përmendura. Konsultimi me palët e interesuara për ndryshimet e këtij kodi solli interpretime dhe sugjerime nga më të ndryshmet në trajtën e një diskutimi me të pranishmit.

## 26 prill, Organizohet edicioni i 12-të i Panairit të Punës



D h o m a A m e r i k a n e ka organizuar edicionin e 12-të të Panairit të Punës, duke i dhënë m u n d ë s i n ë

rreth 1500 aplikantëve të konkurrojnë për rreth 100 pozicione pune. Edhe këtë vit rreth 18 kompani të njohura në vend, hodhën në treg pozicionet e tyre të lira, për të cilat tregu i punës reflektoi një interes të madh. Numri i lartë i aplikantëve ka qenë edhe treguesi më i mirë i interesit që ka zgjuar panairi edhe këtë vit. Këtë edicion dyert e Panairit ishin të hapura për kompani prestigjioze që kanë një emër të njohur në treg, një reputacion të padiskutueshëm dhe që ofronin për tregun e punës rreth 100 vende pune për profesionistë të disa niveleve.

## 6 maj, Mision Tregtar në Çikago

Panairi i Ushqimit dhe i Pijeve në Çikago të Amerikës është ndjekur edhe nga një grup biznesesh të Dhomës Amerikane, të cilët punojnë në sektorin e ushqimit. Grupi i organizuar nga Dhoma Amerikane ka marrë pjesë gjatë tre ditëve të Panairit duke vizituar të gjitha stendat dhe kompanitë pjesmarëse në Panair. Ky Panair është vlerësuar dhe nga ekspertët si një mundësi për të udhëhequr bizneset drejt suksesit si dhe për

mundësitë e bashkëpunimit dhe të kooperimit mes bizneseve të të njëjtit sektor. Nga Shqipëria për këtë Panair



kanë qenë mjaft të interesuar biznese që përfaqësojnë industrinë e fast-food-it dhe të restoranteve. Ky lloj biznesi ka gjetur një informacion të plotë dhe mjaft interesant në Panair dhe mundësi të lidhjes së kontratave dhe rritjes së performacës si biznes. Një seancë interesante në këtë Panair ka qenë dhe Konferenca me ish Presidentin Bill Clinton, i cili u ndoq edhe nga grupi i AmCham-it.

## 24 maj, Pjesmarrje në Konferencën Rajonale për Prokurimet Elektronike

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka sjellë eksperiencën e vet në këtë Konferencë duke referuar mbi projektin e Prokurimit Elektronik që Dhoma zbatoi përpara dy vjetësh. Drejtorja Ekzekutive e Dhomës ka bërë një prezantim të punës që bëri Dhoma për zbatimin e Prokurimit Elektronik tek Operatorët dhe Institucionet publike. Gjetjet e këtij projekti dhe rekomandimet që Dhoma solli nëpërmjet tij, Znj. Faber i ka bërë të njohura gjatë konferencës që u organizua për këtë qëllim.

## 30 maj, Takim me përfaqësues të Institucioneve të Drejtës Intelektuale dhe Pronës



D h o m a A m e r i k a n e organizoi një tryezë të rumbullakët me aktorët kryesorë të çështjes së të Drejtës In-

telektuale në Shqipëri. Përfaqësues të të gjitha institucioneve shqiptare që merren me çështjen e të drejtës së autorit dhe pronësisë intelektuale kanë qenë prezent në takim dhe kanë sjellë informacion të përditësuar mbi atë çfarë po bëhet për ligjin e ri që do të rregullojë marrëdhëniet ndërinstitucionale si dhe do t'i japë zgjidhje shumë çështjeve të IPR-it që sot qëndrojnë pezull. Në takim kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të programeve të USAID-it si dhe të Rritje Albania, të cilat kanë



ofruar edhe mbështetjen e tyre në procesin e rritjes së ndërgjegjësimit për çështjet e IPR-it që ka filluar Dhoma Amerikane e Tregtisë. Në takim, të gjithë pjesëmarrësit kanë bërë një ekspozitë të punës së institucionit që përfaqëson dhe kanë hedhur dritë mbi situatën e përgjithshme të IPR-it në Shqipëri. Në takim janë rrahur ide se si mund të procedohet në të ardhmen, cilat janë rrugët më efektive për të bërë një lobim jo vetëm si organizatë, por dhe një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha institucionet që mbulojnë IPR-in për të ndryshuar situatën në vend.

### **Qershor, Pyetësor i organizuar nga AmCham**

T'i shërbesh në kohë dhe me cilësi biznesit tënd anëtar do të thotë të dish me saktësi se çfarë kanë nevojë ata dhe se çfarë presin nga organizata. Për të realizuar sa më mirë këtë objektiv u shpërnda një pyetësor që tentoi të mblidhte opinionet e të gjithë anëtarëve mbi pritshmëritë e tyre në të ardhmen nga Dhoma. Inisiativa e Bordit të ri Drejtues të Dhomës, që u konfigurua nga zgjedhjet e prillit 2012 synonte të mblidhte informacion të detajuar mbi kërkesat e anëtarëve, mënyrën se si ata e vlerësojnë bashkëpunimin e deritanishëm me Dhomën dhe se çfarë presin në të ardhmen për të mbetur pjesë e kësaj organizate. Pyetësori ka patur dy kategorizime të mëdha të pyetjeve që synojnë të japin një vlerësim për punën e deriatëhershme të Dhomës, dhe sa i kanë shërbyer aktivitetet e organizuara anëtarëve. Një pjesë e pyetësorit ka qenë e fokusuar në çështjet që u ngritën në Axhendën e Biznesit dhe prioritetet që ka Dhoma. Pjesa tjetër është përqendruar në kërkesat e anëtarëve për aktivitete që kanë më shumë nevojë, të ftuarit, ekstrakti i informacionit që duan prej publikimeve, dhe mbi të gjitha, ku duhet të përqendrohet Dhoma në të ardhmen për t'i shërbyer sa më mirë anëtarëve të vet.

### **6 qershor, Takim i përfaqësuesve të FMN-së me përfaqësues të Dhomës Amerikane të Tregtisë**

Një përfaqësi e FMN-së pati një takim me drejtues dhe anëtarë të Dhomës Amerikane të Tregtisë për të folur mbi problematikat që kalojnë bizneset me sistemin tatimor dhe atë fiskal. Anëtarët e Dhomës Amerikane kanë folur mbi problemet që kalojnë si biznes dhe si industri, për shqetësimet që i lidhin me sektorin e tatimeve dhe pritshmëritë që ata kanë .

### **12 qershor, Takim i Komitetit të HR-it**

Panairi i Punës dhe informacioni që mblidhet prej tij,

kanë përbërë tematikën e takimit të Komitetit të HR-it në Dhomën Amerikane.

Çdo vit, ky komitet mblidhet pas organizimit të Panairit, për të diskutuar mbi nevojat që kanë kompanitë anëtare të Dhomës, por edhe kandidatët si edhe për të gjetur forma më bashkohore dhe efektive organizimi. Takimi është përqendruar jo vetëm në rezultatet e pyetësorit që Dhoma shpërndau gjatë Panairit, por edhe tek idetë që kanë anëtarët dhe pritshmëritë e tyre për Panairin e vitit të ardhshëm. Gjatë takimit, kreu i këtij komiteti z. Dritan Mezin, ka folur mbi punën që ka bërë gjatë vitit të kaluar ky komitet dhe idetë për vitin në vazhdim. U informuan anëtarët mbi faktin se Kodi i Punës është në momentet e fundit të hartimit dhe se një pjesë e mirë e komenteve që Dhoma Amerikane ka dorëzuar pranë Ministrisë së Punës dhe grupit që po punon me Kodin, janë marrë në konsideratë.



### **18 qershor, Takim i WoBAC**



Komiteti i Gruas në Dhomën Amerikane të Tregtisë i kushton një vëmendje të veçantë promovimit të bizneseve anëtare dhe sidomos ato që drejtohen nga gra dhe janë të sukseshme, si një shembull pozitiv i forcimit të rolit të gruas në shoqëri. Biznesi i drejtuar nga Elona Çausi, Albania Duty Free, është një nga ato biznese që po spikasin në tregun e produkteve të luksit dhe që ka bërë të mblidhen dhe të flasin për të rejtat që ka patur së fundi ky biznes. Znj. Çausi ka folur shkurtimisht mbi zhvillimet e fundit në biznesin e saj, hapjen e një dyqani të ri tek TEG, ekskluzivitetin e disa produkteve me emër në tregun botëror dhe se si këto produkte po priten nga tregu. Edhe pse biznesi i znj. Çausi ka qenë në qendër të vëmendjes, takimi është fokusuar në punën dhe aktivitetin e përditshëm të anëtarëve të WoBac dhe mbi të gjitha në atë se çfarë ato presin nga Komiteti.

## 30 qershor, Party për Ditën e Pavarësisë së SHBA-së. Festa e 4 korrikut

Dhoma Amerikane ka përsëritur ritualin e përvitshëm të festimit të Ditës së Pavarësisë të Amerikës, duke bashkuar bashkë rreth 800 shqiptarë dhe amerikanë në ditën më të rëndësishme të kombit Amerikan.



Ambjentet e Shkollës Wilson janë mbushur nga anëtarët dhe fëmijët e tyre si dhe qytetarët amerikanë, të cilët kanë respektuar himnet kombëtare dhe prerjen e kekut të ditëlindjes, për të shijuar të gjithë elementët e festës tipike Amerikane. Presidenti i Dhomës Amerikane, z. David Anderson, duke përshëndetur të gjithë të pranishmit ka kujtuar shkurtimisht historikun e Ditës së Pavarësisë. *“Sensi që na ndryshon nga të tjerët ka të bëjë me konceptin e ndriçimit dhe të respektit që kalon në breza dhe nuk vjen me orientimin nga lart-poshtë, por nga poshtë-lart”*- tha Ambasadori Arvizu.

## Korrik, Dhoma Amerikane merr pjesë në Mbledhjen e Këshillit Konsultativ të Biznesit

Këshilli Konsultativ i Biznesit ka vendosur të rishikojë ligjin e organizimit të tij me qëllimin që të krijojë hapësira më të gjera vendimarrjeje në këtë Këshill nga komuniteti i biznesit dhe forma më efikase të funksionimit. Dhoma Amerikane që është pjesë e këtij Këshilli që nga themelimi e ka marrë seriozisht kërkesën për të sjellë komentet dhe kërkesat e veta mbi projektligjin e ri dhe ka reflektuar në këto kërkesa nevojat imediate të organizatës. Presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë, z. David Anderson, ka marrë pjesë në takim të bashku me Drejtoren Ekzekutive Floreta Luli-Faber dhe anëtarin e ri të Dhomës në këtë Këshill z. Benard Shehu. Përfaqësia e lartë e Dhomës ka patur për qëllim të prezantojë angazhimin që Dhoma ka nëpërmjet këtij këshilli dhe nevojën për të ndryshuar disa gjëra esenciale në punën e tij.

## Korrik, Dhoma angazhohet në Lobimin për mbrojtjen e industrisë së importit të mishit

Industria e përpunimit të mishit në Shqipëri rrezikoi falimentin falë një urdhëri të nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë që synonte të përafronte legjislacionin

shqiptar me atë të BE-së duke ndaluar importin e mishit nga Amerika. Përballë kësaj situatë kanë reaguar Bashkimi i Shoqatës Importueseve dhe Përpunuesve të Mishit (AMIPAA) e cila i është drejtuar menjëherë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrit Ruli duke arsyetuar bindshëm pabazueshmërinë në ligj dhe impaktin negativ që do ketë implementimi i këtij urdhëri. Më pas ka kërkuar edhe ndërhyrjen e Kryeministrit Berisha. Në këtë fushatë lobuese është angazhuar edhe Dhoma Amerikane e Tregtisë dhe Presidenti i saj z. David Anderson që gjatë një takimi me AMIPAA kanë dialoguar gjatë mbi informacionin ligjor që nevojitej si dhe strategjinë që duhej ndjekur për të arritur një objektiv të rëndësishëm, atë të revokimit të urdhërit.

## 19 korrik, Mëngjes Pune me Ambasadorin Arvizu

Shoqëria civile është promotori kryesor i demokratizimit të vendit dhe roli i një organizate biznesi



si AmCham është jo vetëm që të punojë për zhvillimin e një klime të qëndrueshme për biznesin Amerikan, por dhe për rritjen e nivelit social dhe ekonomik të vendit. Këto dy objektiva kanë krijuar lehtësisht tema bisede në tavolinën e rrumbullakët në “Mëngjesin e Punës” që Ambasadori Arvizu ka patur me Bordin e ri të Dhomës Amerikane. Gjatë takimit është folur për investimet Amerikane në vend, lëvizjen “Act Now”, që përfshin shoqërinë civile, format me të cilat AmCham dhe Ambasada mund të bashkëpunojnë dhe të mbështesin fuqimisht njëra-tjetrën në realizimin e këtyre dy objektivave. Lëvizja “Act Now” dhe impakti që ajo ka në shoqërinë civile dhe roli që duhet të luajnë NGO-të në këtë lëvizje ka qenë një temë e rëndësishme e bisedës. Ambasadori Arvizu ka theksuar qëllimin e kësaj lëvizjeje dhe ndryshimeve që ajo duhet të sjellë në mentalitetin dhe në sjelljen e shoqërisë civile, e cila duhet të bëhet promotori i lëvizjeve të reja demokratike në vend.

## 25 korrik, Amerika, toka e premtuar, duket më afër se kurrë për prodhuesit shqiptarë dhe produktet “Made in Albania”

Presidenti Amerikan Barak Obama ka firmosur

edhe për këtë vit një listë të gjatë me rreth 3500 produkte që mund të hyjnë në tokën Amerikane pa paguar taksa doganore dhe Shqipëria është një ndër 128 vendet që përfiton nga ky privilegj. “Ka një listë të gjatë produktesh, e cila firmoset çdo vit nga vetë Presidenti i SHBA-së, të cilat biznesmenët shqiptarë mund t’i dërgojnë në SHBA me më pak kosto se vendet e tjera përreth, anëtare të BE-së” – tha Zëvendës Asistenti i Programit, Bill Xheksion pranë përfaqësuesit të SHBA-së për tregtinë gjatë takimit që Programi i USAID “Konkurrueshmëria e Bujqësisë Shqiptare“, Dhoma Amerikane dhe Ambasada Amerikane organizuan për të informuar bizneset shqiptare. Takimi ka patur për qëllim të njohë dhe njëkohësisht të ndërgjegjësojë bizneset shqiptare që të njohin dhe ta shfrytëzojnë këtë sistem preferencial si një mundësi e mirë e ekspansionit të biznesit të tyre edhe në tregje që duken të largëta e të paarrtshme, por që sjellin sot mundësi të reja.

#### 5 shtator, Takim i Komitetit të Taksave dhe Ligjeve

Takimi peri-odik i Komitetit të Taksave dhe Ligjeve hodhi dritë mbi mjaft probleme të cilat kalon



biznesi dhe i adreson në organizatën ku aderojnë. Ky takim i parapriu takimit “Forum Biznesi” ku ishte i ftuar z. Gazmir Spahija dhe shërbeu për të kristalizuar idetë dhe rrugët që duhet të ndjekë Dhoma për të zgjidhur çështjet dhe problemet e anëtarëve të saj. Rastet e prezantuara nga anëtarët kanë treguar se nuk janë probleme individuale, por fenomene që po prekin industri të ndryshme. Dhoma Amerikane ka listuar tre çështje themelore dhe një seri me problematika të ndara sipas sektorëve, për t’i prezantuar ato në takimin me Drejtorin e Tatimeve.

#### 12 shtator, Forum Biznesi

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka përcjellë nëpërmjet një aktiviteti publik shqetësimin e industrive të ndryshme që bashkohen në një pikë të vetme dhe fajësojnë institucionin tatimor për një fushatë të egër tatimore, gjoba të larta të pajustificuara

dhe kontrole abuzive që po cënojnë të ardhmen e biznesit të tyre. Një sjellje e tillë ka vënë në dyshim



premtimin disa vjeçar të kryeministrit për dialog dhe bashkëpunim konstruktiv për përmirësimin e klimës së biznesit. Tentativa disa mujore për t’u ulur në të njëjtën tryezë me kreun e tatimeve dhe për të zhvilluar një formë dialogu konstruktiv ka dështuar, duke e detyruar Dhomën që mesazhin e saj për tatimorët ta përcjellë nëpërmjet medias. Presidenti i Dhomës Amerikane z. David Anderson ka qenë i drejtpërdrejtë kur ka deklaruar se problemet që po kalon sot biznesi janë pasojë e sjelljes abuzive të tatimorëve.

#### 24 shtator, WoBAC merr pjesë në Ekzpozitën e Studio Cubi

100 vjet Pavarësi ka qenë një temë e mjaftueshme jo vetëm për historianët, por dhe për artistët, të cilët impulset e tyre artistike i kanë përkthyer në art. E tillë ka qenë dhe ekspozita e Myftar Cubit, i cili është paraqitur përpara publikut me një ekspozitë personale me punime mozaiku në gurë. Nga figurat e mbretit Zog tek ato të patriotëve shqiptarë, kanë qenë të gdhendur në gurë nga dora e kujdesshme e Myftarit, i cili ka mundur nëpërmjet artit të tij të sjellë figurat reale të tyre. Në inagurimin e ekspozitës nuk kanë munguar me dhjetra përfaqësues të botës akademike e të artit si dhe miq dhe dashamirës.

#### 24 shtator, Takim i Dytë i Përfaqësuesve të Institucioneve të Mbrojtjes Intelektuale

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka organizuar së fundi një seri me tryeza të rrumbullakta me grupet e interesit për çështjet e IPR-it, duke e përcjellë këtë tematikë edhe në mbledhjen e Komitetit të IPR-it. Informacionet e mbledhura nga këto takime do të ndihmojnë Dhomën të kuptojë lidhjen e ndërsjellë institucionale për çështjet e IPR-it dhe se ku janë pikat më të dobëta ku duhet të llobojë për të çuar përpara reformat dhe zbatimin me rigorozitet të ligjit. Inisiativa e AmCham-it, për t’u marrë me çështjet e IPR-it, si një kërkesë e fortë e anëtarëve të saj, është konkretizuar edhe në krijimin e komitetit të IPR-it, i cili bashkërendon punën dhe përcakton



prioritetet me të cilat duhet të merret Dhoma, për të mbrojtur çështjen e IPR-it.

## 27 shtator, Takim i Komitetit të IPR-it.



Ky takim u fokusua në çështjet e dala për diskutim nga takimet e stakeholders group si dhe për konfigurimin

e një prej aktiviteteve më të mëdha vjetore që organizon AmCham-i nëpërmjet Komitetit të IPR-it, Konferencën Vjetore të IPR-it. Gjatë takimit është diskutuar mbi punën që ka bërë Komiteti gjatë 2012-ës si dhe feed back-un e marrë nga takimet me stakeholder. Diskutimet mbi informacionin e marrë nga përfaqësuesit e institucioneve shtetërore për ecurinë e reformave ligjore dhe institucionale për sa i takon IPR-it kanë zënë gjithashtu një vend të rëndësishëm në takim ku dhe janë diskutuar format që duhet të ndjekë Dhoma për të qenë e përditësuar me ecurinë e reformës.

## Tetor, Dhoma Amerikane merr pjesë në Forumet e Ekonomike

Dhoma Amerikane ka marrë pjesë në tavolinat e punës që kanë organizuar me biznesin Partia Socialiste, por edhe kryeministri z. Sali Berisha. Të dy këto takime kanë patur në qendër bashkëpunimin që dy forcat kryesore politike të vendit duan të kenë me klasën me të fuqishme ekonomike të vendit, biznesin, si një formë bashkëpunimi që sjell sukses në qeverisje. Duke e konsideruar mjaft të rëndësishëm bashkëpunimin që organizata duhet të ketë me politikën dhe me partinë që qeveris vendin, Dhoma Amerikane është prezantuar edhe njëherë në të dy tavolinat me Axhendën e Biznesit, si platforma zyrtare e Dhomës dhe plani i saj për të ardhmen.

## 2 tetor, Takim Pune me z. Filip Riker

Bordi i Dhomës Amerikane ka patur një darkë pune me Zëvendësasistentin për Europën Qendrore dhe Lindore, z. Filip Riker. Gjatë takimit, z. Riker foli për eksperiencën e tij në Rajon dhe si Ambasador në Maqedoni, punën që ka patur në këto vende si edhe për bashkëpunimin e frytshëm që ka patur në atë kohë seksioni ekonomik i Ambasadës me Dhomën Amerikane. Nga ana e tij, Presidenti i Dhomës

Amerikane z. David Anderson e ka njohur z. Riker me aktivitetet e fundit të Dhomës, objektivat themelore,



punën e përqendruar tek lobimi dhe mbrojtjen e interesave si edhe me Axhendën e Biznesit si plan-aksioni i shpallur dhe më i rëndësishëm i Dhomës. Anëtarët e Bordit kanë patur një bisedë të gjatë me z. Riker për sa i takon çështjeve themelore që kalon biznesi sot në Shqipëri, marrëdhëniet me qeverinë, zhvillimet ekonomike në sektorët prioritarë, pritshmëritë mbi privatizimet strategjike dhe mënyrën se si biznesi e shikon të ardhmen e zhvillimit të vendit.

## 17 tetor, Mbledhje e Komitetit të Taksave dhe Ligjeve

Anëtarët e Dhomës Amerikane të Tregtisë diskutuan në mbledhjen e fundit të Komitetit të Taksave dhe Ligjeve ndryshimet ligjore të prezantuara nga Ministria e Ekonomisë dhe kanë bërë komentet e tyre për disa nga këto ndryshime. Propozimet e tyre prekin ato projektligje, impakti i të cilëve nuk bie mbi një numër të kufizuar biznesesh, por prek një industri të tërë apo një segment të caktuar të biznesit. Të tilla kanë qenë ndryshimet për tatimin mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël, rritjen e ndjeshme të gjobës për mosdeklarimin e punonjësve në kohën kur nuk funksionon siç duhet sistemi on-line për deklarimin e punëmarrësve, heqjen e TVSH-së për makineritë në investime me vlerë mbi 50 milion lekë etj. Ky takim diskutoi edhe çështjet që do të ngriheshin në takimin me DPT-në.

## 22 tetor, Krijohet forumi i CEO-ve

Eshtë mbledhur për herë të parë pas ftesës që iu drejtua të gjithë CEO-ve të kompanive presidenciale, Forumi i CEO-ve.



Kjo inisiativë e Dhomës, tenton të mbledhë në një forum krerët më të lartë ekzekutivë të kompanive më me emër në Shqipëri, për të patur

një mbështetje në politikat që zbaton Dhoma si dhe për të marrë opinionin dhe mendimin e tyre për të gjitha çështjet që mbështet Dhoma Amerikane e Tregtisë. Ky forum, jo vetëm që do të ketë akses në hartimin e politikave të Dhomës, por do të jetë targeti i parë për takime të rëndësishme dhe të nivelit të lartë me drejtues shtetërorë apo të organizatave ndërkombëtare që organizon Dhoma për arsye të angazhimit të saj institucional, publik apo për të siguruar mbarëvajtjen e politikave të veta. Takimi ka patur edhe prezencën e Zëvendësambasadorit Amerikan Henry Jardine, i cili ka dhënë mbështetje të plotë për këtë strukturë, madje ka planifikuar dhe organizimin e një takimi të Ambasadorit Amerikan me të gjithë CEO-t e këtij forumi.

### 23 tetor, Takim me Kreun e Doganave



Çmimi i referencave ka qenë në qendër të vëmendjes në aktivitetin Forum Biznesi që Dhoma Amerikane

organizoi me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Probleme ka patur edhe për mallrat e sjella nga vendet e BE-së, që kanë një sistem shumë strikt të faturimit. Edhe për mallrat që vijnë nga Amerika dhe Kanadaja. Nga takimi u kërkuar që Drejtoria e Doganave ta marrë në konsideratë këtë fakt dhe të mos aplikojë çmimin e referencës për mallra që vijnë nga vende të tilla që e kanë zero mundësinë e abuzimit me faturat. Forumi i Biznesit ka patur si tematikë të vetën trajtimin e çështjeve shqetësuese që vijnë prej biznesit anëtar të Dhomës nga specialistët e Drejtorisë së Doganave dhe vetë drejtuesi i doganave. Fryma e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit, për t'i dhënë zgjidhje problemeve të shfaqura ka karakterizuar takimin i cili ka prekur pothuajse të gjitha çështjet që erdhën nga anëtarët e Dhomës nëpërmjet Komitetit të Taksave dhe Ligjeve.

### 24 tetor, Tavolina e tretë e rrumbullakët e përfaqësuesve të Institucioneve të IPR-it

Dhoma ka vazhduar me takime e grupit të stakeholderave për çështjet e IPR-it si një inisiativë që ndihmojnë në lobimin e Dhomës për këtë çështje. Gjatë periudhës shtator-nëntor, Dhoma ka mbledhur në dy tryeza të ndryshme përfaqësues

nga të gjitha institucionet shtetërore që mbulojnë çështje të së drejtës intelektuale dhe pronësisë si dhe të ministrave përkatëse. Qëllimi ka qenë që të merret informacion i përditësuar mbi lëvizjen e reformave, miratimin e ligjit të ri për të drejtën intelektuale dhe fillimin nga punë të Inspektoriatit Qendror.

### 31 tetor, Bordi Drejtues i Dhomës Amerikane të Tregtisë është takuar në një 'Mëngjes Pune' me Ambasadorin e BE-së në Tiranë, z. Etoe Sekui

Takimi ka patur të paracaktuar një axhendë temash që synonin ta njihnin z. Sekui me punën që po bën Dhoma



në fushën e lobimit si edhe çështje të tjera themelore në interes të anëtarëve. Zëvendëspresidenti i Dhomës Amerikane, z. Arsen Kurti, e ka njohur Ambasadorin e BE-së shkurtimisht me çështjet themelore të Axhendës së Biznesit, të cilat pas pyetësorit që ka bërë Dhoma me anëtarët përbëjnë dhe prioritetet kryesore të saj. Të tre prioritet, puna për përfshirjen e komunitetit të biznesit në hartimin e miratimit të ligjeve, lobimi për politikat fiskale dhe çështja e pronës së tokës, janë konsideruar si mjaft të rëndësishme nga z. Etoe Sekui. Një interes të veçantë z. Sekui ka shfaqur edhe për çështjen e IPR-it, në të cilën Dhoma është përfshirë jo vetëm nëpërmjet komitetit të IPR-it, por dhe tryezave të rrumbullakta që po organizohen në mënyrë periodike me 'stockholders' dhe konferencave vjetore, të cilat i kushtohen pikërisht kësaj çështjeje.

### Nëntor, 100 vjet Dhomë Amerikane

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri feston në vitin jubilar të shqiptarëve jo vetëm 100 vjet Pavarësi, por edhe 100 vjet histori si organizata më e vjetër dhe më e fuqishme e biznesit në Amerikë. Në 1912 shqiptarët përpigeshin të shpëtonin sovranitetin e tyre duke u organizuar për lëvizjen që do të bënte një histori. Në të njëjtën kohë, Amerika ndiente nevojën të krijonte një formë organizative për të mbështetur biznesin përmes një organizate që u quajt Dhoma Amerikane e Tregtisë në Uashington. Filloi me një sugjerim të Presidentit Howard Taft në vitin 1912 për nevojën e një organizate qendrore e lidhur me organizatat dhe Dhomat e tjera në të gjithë vendin



dhe që prej asaj dite, Dhoma Amerikane e Tregtisë ka qenë zëri i biznesit Amerikan prej 100 vjetësh. Që prej asaj dite, Dhoma ka krijuar 100 vjet histori, duke mbështetur biznesin Amerikan dhe duke promovuar investimet amerikane në Amerikë dhe anembanë botës.

## 6 nëntor, Zgjedhjet Presidenciale në Amerikë



Kush do të jetë Presidenti i ardhshëm i Amerikës, ka qenë pyetja që miliona njerëz i kanë bërë vetes gjatë

Zgjedhjeve Presidenciale në Amerikë. Emocionin dhe ankthin e pritjes së orëve të fundit Dhoma Amerikane e Tregtisë në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane e ka ndarë me shumë miq e të ftuar. Në top listën e të ftuarve që iu bashkuan këtij aktiviteti kanë qenë edhe Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani, Ministri i Jashtëm, z. Edmond Panariti dhe Ambasadori Amerikan, z. Aleksandër Arvizu. Ambientet e Hotel Rogner kanë qenë të mbushura në mbrëmjen e datës 6 nëntor me përfaqësues të biznesit, shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore, të cilët nëpërmjet stacionit CNN kanë marrë informacion të përditësuar mbi atë se çfarë po ndodhte ditën e zgjedhjeve në Amerikë, për të kulmuar me mëngjesin e datës 7 nëntor, kur Ambasadori Amerikan ka mundur ndjekjen direkt të rezultatit paraprak të zgjedhjeve. Presidenti i Amerikës i rizgjedhur z. Barak Obama ka mbajtur një fjalim i cili është dëgjuar nga miliona amerikanë, por dhe nga qindra shqiptarë të mbledhur në Hotel Rogner.

## 19 nëntor, Lobimi i Dhomës për Gjykatën e Lartë Administrative

Gjykata Administrative dhe përpjekja një vjeçare për të mundur miratimin e ligjit njihet si një nga fushatat lobuese me të forta të Dhomës në bashkëpunim me organizatat e tjera. Miratimi i këtij ligji erdhi me vonesë por gjithsesi u përshëndet nga Dhoma, e cila u ndie e realizuar në përpjekjen e saj. Dhoma Amerikane fillimisht nëpërmjet një deklarate për shtyp tentoi të dërgonte një mesazh të qartë tek politika dhe parlamenti për miratimin e Ligjit të Gjykatës së lartë, reforma e së cilës do t'i hapë rrugën hapjes së Gjykatës Administrative.

## 20 nëntor, Lobim i Dhomës në bashkëpunim me organizatat e tjera të biznesit

Në këtë lëvizje Dhoma u përkrah dhe nga një grup organizatash të tjera, të cilat e konsideruan si të drejtë lëvizjen e komunitetit të biznesit për të patur një Gjykatë Administrative. Shtatë organizata biznesi mes të cilave Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri, Dhoma Britanike e Tregtisë dhe Industrisë në Shqipëri, Shoqata e Grave Profesioniste dhe Afariste të Shqipërisë, Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, Shoqata për Industrinë dhe Tregtinë Gjermane në Shqipëri, Shoqata Shqiptare e Bankave, firmosën një thirrje e cila i kërkoi Parlamentit miratimin pa vonesë të ligjit të Gjykatës së Lartë.

## Nëntor, Letër për Ligjin e TVSH-së tek Ambasadori Sekui

Puna e Ministrisë së Financës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të përafuar legjislacionin fiskal me atë të EU-së ka bërë që të hartohet një ligj i ri për TVSH-në në të njëjtën linjë me direktiven e 6-të të BE-së. Ligji i asistuar dhe nga ekspertët e BE-së është në hapat e fundit të tij dhe informacionet flasin se qeveria kërkon ta aplikojë atë, duke filluar nga 1 janari 2013. Pikërisht, aplikimi me urgjencë i këtij ligji që do të ketë një impakt të gjerë në ekonominë e vendit, ka shqetësuar Dhomën Amerikane, e cila i është drejtuar me një letër Ambasadorit Sekui duke i renditur disa argumenta në lidhje me formën në të cilën ligji duhet të diskutohet në publik e më pas të fillojë zbatimin. Në frymën e bashkëpunimit që AmCham ka me Delegacionin e EU-së, e gjen me vend që të kërkojë bashkëpunimin e tyre. Dhoma mendon se është me vend që ligjit pas hartimit t'i lihet një periudhë kohe 3 muajore për diskutim me grupet e interesit dhe paralelisht me ligjin të jenë të miratuara dhe të diskutohen në publik dhe aktet nënligjore dhe instruksionet e zbatimit.


## 6 dhjetor, Konferenca e Dytë e IPR-it

D h o m a A m e r i k a n e e T r e g t i s ë në Shqipëri për herë të dytë ka organizuar një konferencë për çështjet e IPR-



it, ku ka bashkuar në një sallë të vetme të gjithë aktorët e këtij tregu problematik për t'i përditësuar të gjithë me atë çfarë ndodh realisht në Shqipëri, ku qëndron problemi me ligjin dhe zbatimin e tij, çfarë thonë bizneset dhe si reagojnë institucionet. Konferenca ka patur vëmendjen e diplomatëve, Ambasadorit Arvizu dhe Ambasadorit Sekui, të cilët kanë sjellë opinionin e tyre për situatën e IPR-it në vend. Në konferencë qeveria ka qenë e përfaqësuar nga Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Ekonomisë z. Haxhinasto, i cili ka përshëndetur takimin. Por nivelit të bisedimeve gjithsesi i ka munguar një përfaqësi e zgjedhur e qeverisë dhe e institucioneve që merren me çështjet e IPR-it si Ministria e Integritetit dhe ajo e Kulturës. Konferenca e dytë e IPR-it është fokusuar në çështjet e pronësisë intelektuale, si shkëlja e të drejtave të autorit, konkurrenca e padrejtë, mbrojtja e interesave të konsumatorëve, pirateria, etj.

## 11 dhjetor, Pritje për Forumin e CEO tek Rezidenca e Zëvendësambasadorit Amerikan, z. Zhardin



Forum i CEO-ve ka organizuar deri më sot tre takime, të cilat kanë qenë të përqendruara në diskutimin

e politikave dhe çështjeve me të cilat do të merret ky Forum i lartë brenda Dhomës. Takimi i parë ka qenë për të shpallur krijimin e Forumit dhe për të marrë opinionin e anëtarëve mbi çështjet me të rëndësishme me të cilat duhet të merret Forumi. Në mbështetje të këtij qëllimi, z. Henri Zhardin ftoi anëtarët themelues të Komitetit në rezidencën e tij, për të folur konkretisht për platformën e punës që duhet të ketë ky Forum. Takimi i radhës i Forumit të CEO-ve ka patur sërish praninë e Zëvendësambasadorit Henri Zhardin dhe është përqendruar në diskutimin e rrugëve dhe strategjive që duhet të ndiqen për të zgjidhur çështjet e prezantuara edhe në takimin me kryeministrin. Takimet e Forumit të CEO-ve janë të planifikuara një herë në tre muaj dhe kanë gjithnjë në axhendën e tyre çështje të rëndësishme të lobimit të Dhomës.


## 12 dhjetor, Takim i Komitetit të WoBAC

Bordi i AmCham ka zgjedhur kryetaren e re, e

cila është Flutura Veipi nga Pro Credit Bank dhe katër anëtare permanente. Grupi Permanent ka organizuar një takim me anëtarët e komitetit, ku është bërë prezantimi i kryetares së re dhe grupit permanent si edhe të ideve mbi objektivat ku duhet të përqendrohet puna e këtij komiteti. Gjatë takimit, është shpërndarë edhe një pyetësor për të tërhequr mendimin e anëtarëve mbi tematikat që duan të diskutohen gjatë vitit. Komiteti i WoBAC-ut, pas tërheqjes së mendimeve të vetë anëtarëve të komitetit ka përcaktuar shtyllat qendore të aktiviteteve të saj gjatë vitit 2013. E gjithë veprimtaria do të ndahet në dy kategori qendrore. Objektivi afatgjatë ka të bëjë me forcimin e rolit të gruas në jetën politike në biznes dhe në shoqëri dhe për të mbështetur këtë objektiv do të organizohen takime me nivele të larta të grave të përfaqësuar në politikë e parlament. Gjithashtu, do të organizohen takime me kryetarët e Partive për të kërkuar respektimin e 30 përqindshit në listat e deputetëve. Gjithashtu, janë planifikuar takime me përfaqësues të lartë të BE-së për të kërkuar ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre në përpjekjet për të emancipuar jetën politike dhe shoqërore të vendit.

## 18 dhjetor, Forumi i CEO-ve Drekë Pune me Kryeministrin Berisha

Dialogu me qeverinë dhe krijimi i një klime bashkëpunimi është një prej çështjeve më të rëndësishme



të Dhomës Amerikane. Këtë pikëpamje, Forumi i CEO-ve ja ka paraqitur vetë kryeministrin Berisha në takimin e organizuar me të, duke e njohur më nga afër me gjithë problematikën që kjo organizatë ka hasur pikërisht në mungesën e dialogut që ka mes saj dhe institucioneve financiare dhe tatimore në vend. Dhoma e ka falenderuar z. Berisha që pranoi menjëherë ftesën për të marrë pjesë në takim, një praktikë pune kjo jo shumë e njohur me instancat e tjera qeveritare për të cilat organizimi i një takimi po kthehet në një ritual tepër të vështirë. AmCham ka patur shumë çështje për të diskutuar me kryeministrin në lidhje me zbatimin e ligjit në Shqipëri dhe aplikimin e tij ndaj problematikave

fiskale dhe ligjore me të cilat përballlet komuniteti shqiptar i biznesit në Shqipëri.

### Dhjetor, Mëngjes Pune me Xhonatan Mur



Vizita e shkurtër në Shqipëri e z. Xhonatan Mur, Drejtor i Departamentit të Shtetit për Europen Juglindore,

ka patur të rezervuar dhe hapësirën kohore për Dhomën Amerikane të Tregtisë. Bordi Drejtues i Dhomës Amerikane ka patur një Mëngjes Pune me z. Mur, ku është folur gjerësisht për zhvillimet ekonomike, klimën e biznesit dhe krijimin e kushteve për thithjen e investimeve amerikane në Shqipëri. Anëtarët e Dhomës Amerikanë kanë sjellë në vëmendjen e z. Mur edhe çështje të tjera me të cilat është duke punuar Dhoma për të zhvilluar një klimë optimale të të bërit biznes në vend, që do t'i hapë edhe rrugën investimeve të huaja. “Rimbursimi i TVSH-së dhe dialogu me institucionet janë çështje për të cilat po punojmë. Duhet që të dëgjohet zëri i biznesit dhe të jemi më aktiv sidomos këtë vit që është dhe vit elektoral. Biznesi duhet të jetë

një partner, zëri i të cilit duhet të dëgjohet” – është thënë gjatë takimit.

### 20 dhjetor, Mbrëmja e Vitit të Ri

Mbrëmja e Vitit të Ri këtë vit ka patur ngjyrat e festës kombëtare kuq e zi dhe dekori i është përshtatur tematikës së 100 Vjetorit të Pavarësisë. Madje edhe torta surprizë është ndërtuar nga pastičierët që prodhuan



respektuar edhe dizajnin e tortës. Dhoma Amerikane e Tregtisë ka

festuar një tjetër fund viti në shoqërinë e anëtarëve të saj, me të cilët ka bashkëpunuar për të zhvilluar aktivitetin e saj lobues dhe informues. Mbi 200 pjesëmarrës u bënë pjesë e aktivitetit më festiv që organizon Dhoma. Tradicioni i mbrëmjes së fundvitit është zhvilluar nga viti në vit me element që i japin festës ngjyra jo vetëm të spektaklit, por dhe të bashkëpunimit dhe zhvillimit të network-ut mes anëtarëve. Çmimet që shpërndahen në formën e llotarisë gjatë mbrëmjes janë dhurata të ofruara nga vetë anëtarët.

## SPONSORIZIME

Edhe gjatë vitit 2012, sikurse edhe në vitet e kaluara, anëtarët e Dhomës Amerikane të Tregtisë, kanë shprehur interesin që promovimin e biznesit të tyre në Shqipëri ta bëjnë edhe nëpërmjet sponsorizimit të aktiviteteve të ndryshme të organizuara nga Dhoma Amerikane. Dhoma Amerikane ofron mjetin ideal të marketingut për promovimin dhe njohjen e emrit të kompanive të cilat sponsorizojnë aktivitetet e saj. Festa e 4 Korrikut-Dita e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Nata e Zgjedhjeve Amerikane, Konferenca e IPR-it apo dhe Mbrëmja e Madhe e Festave të Fundvitit kanë qenë disa nga aktivitetet kryesore të mundësuar nga

sponsorizimet e disa prej kompanive anëtare të Dhomës.

Gjithashtu, tashmë është bërë traditë në AmCham që disa nga kompanitë të sponsorizojnë me produktet që ata prodhojnë dhe këtu përmendim Festën e 4 Korrikut dhe Mbrëmjen e Madhe të Festave të Fund Vitit.

Edhe këtë vit, Dhoma Amerikane falenderon të gjithë sponsorat dhe mbështetësit e aktiviteteve të saj dhe shpreson që reklama e Dhomës të ketë ndikuar sadopak në promovimin e biznesit të tyre në Shqipëri.



## BORDI DREJTUES

AmCham-i në Shqipëri drejtohet dhe administrohet nga Bordi Drejtues. Bordi përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë. Anëtarët e Bordit, ku bëjnë pjesë Presidenti, Zëvendëspresidenti, Përgjegjësi i Thesarit, Sekretari dhe shtatë anëtarë të tjerë që zgjidhen në Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë së Dhomës. Bordi miraton buxhetin e Dhomës, shqyrton dhe aprovon aplikimet për anëtarësim, adapton statutin themelor, miraton strukturën dhe personelin e Dhomës.

Bordi Drejtues përmes mbledhjeve të organizuara çdo muaj dhe aktiviteteve, ndihmon në zbatimin, nxitjen e politikave dhe objektivave

të Dhomës. Një pjesë e Bordit zgjidhet vitin e parë dhe pjesa tjetër vitin e ardhshëm.

Në vitin 2012, Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë zgjodhi një Bord tërësisht të ri. Një Anëtar Bordi, përfaqësuesi i Philip Morris hoqi dorë nga pozicioni i tij në Shqipëri, dhe tashmë nuk i shërben Bordit Drejtues të AmCham-it. Përfaqësuesi i Lincoln në Bordin e AmCham-it, nuk punon më për këtë kompani. Bazuar në Nenin 12 pika 9 të Statutit të AmCham-it, Bordi i Dhomës Amerikane të Tregtisë realizoi zëvendësimet. AmCham-i e mbylli vitin 2012 me Bordin Drejtues, si ne vijim:



David Anderson  
*President*  
DAI-AAC  
E-mail: david\_anderson@dai.com



Benard Shehu  
*Sekretar*  
Konsort  
E-mail: benard.shehu@konsort.com



Adrian Shehu  
*Anëtar Bordi*  
T.C.N.- Telecommunication &  
Computer Networking  
E-mail: adshehu@tcn.al



David Jaime  
*Anëtar Bordi*  
Individ  
E-mail: dijaime@gmail.com



Flutura Veipi  
*Anëtar Bordi*  
Procredit Bank Sh.a  
E-mail: F.Veipi@procreditbank.com.al



Steve Nutley  
*Anëtar Bordi*  
KPMG Albania  
E-mail: snutley@kpmg.com



Arsen Kurti  
*Zv. President*  
Microsoft Albania  
E-mail: arsenk@microsoft.com



Laura Qorlaze  
*Përgjegjëse për Thesarin*  
Avantive Consulting  
E-mail: laura.qorlaze@avantive.al



Aleksandër Sarapuli  
*Anëtar Bordi*  
Fondi Shqiptaro-Amerikan i  
Ndërmarrjeve  
E-mail: a.sarapuli@aaef.com



Elton Çollaku  
*Anëtar Bordi*  
Unioni Financiar i Tiranës -  
Western Union  
E-mail: elton.collaku@unionifinanciar.al



Loreta Peçi  
*Anëtar Bordi*  
PricewaterhouseCoopers Audit  
E-mail: loreta.peci@al.pwc.com



Floreta Luli-Faber  
*Drejtoresh Ekzekutive*  
Dhoma Amerikane e Tregtisë  
në Shqipëri  
E-mail: floreta@amcham.com.al



### Lista e Anëtarëve

Anëtarë legjitimë të AmCham-it (sipas Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë, 12 prill 2012)

1. Intesa Sanpaolo Bank
2. Coca-Cola Bottling Shqiperia
3. Financial Union Tirana - Western Union
4. DHL International Albania Ltd.
5. Alban
6. Bozgo
7. Artinel
8. Embassy of the United States
9. Professional & Business Women Association
10. Enrico-Marinelli
11. CCS Computer & Copier Systems
12. Kërmilli
13. Mermer Balliu
14. Kalo & Associates
15. Auto Star Albania
16. Bindi
17. Albanian - American Enterprise Fund
18. Birra Korça
19. Regional Development Agency, Korça
20. Loloçi & Associates
21. Harry T. Fultz Foundation
22. NOA
23. BOGA & Associates
24. KPMG Albania
25. Bukuria Shqiptare Beli
26. Deloitte Albania
27. Andela (Wilson School)
28. S.A.B.
29. Sweet-Shop Behari
30. T.C.N.- Telecommunication & Computer Networking
31. Golden Eagle sh.p.k. - Rogner Hotel Europapark
32. Abcom
33. Bar-Gallery-Art
34. DDB Albania
35. Marketing & Distribution, Albania
36. AlbAtlas
37. GSA
38. Sigma
39. Llambi Karbunara
40. ZICO
41. Vodafone Albania
42. Gerta
43. BJORNI
44. A Bi Esse
45. SIGAL
46. Mifol Inerte
47. Aiba Co
48. ECOBI Albania
49. Ambra S.r.l.
50. Ni. L.A.
51. Emigres
52. SUCRALBA
53. D. D. 06
54. IDRA-Institute for Development Research and Alternatives
55. ALD-KRIS
56. Aurora Group
57. Abraham Lincoln Foundation of Albania
58. Lockheed Martin Global Inc.
59. Kantina e Pijeve Gj. K. Skenderbeu
60. Sheraton Tirana Hotel
61. Intech +
62. United Transport-UPS
63. Studio Mallkuçi & Sadushaj
64. Everest IE
65. Prespa 2000
66. Miell - Tirana
67. Jordil
68. Alba Milk
69. Real Estate "INF 93"
70. Donianna
71. Zaka & Kosta Attorneys at Law
72. Tashko Pustina - Attorneys
73. Furra Blea
74. KESH
75. Flast
76. Ulysses Enterprises
77. Comport
78. Kika
79. Regional Development Agency, Tirana
80. Raiffeisen Bank
81. InterAlbanian
82. International Commercial Bank
83. Tafaj "Z"
84. Fufarma
85. Real Com
86. Ak-Invest
87. Anita Milk
88. P.V.N. Colosseo
89. Bar-Restorant "Shqiponja"
90. Tirana International Airport
91. B.A.D.
92. A & A Group
93. PricewaterhouseCoopers Audit
94. R & T
95. Taçi Oil International

96. ANDE-LM Agency
97. A.E. Distribution
98. University of New York Tirana
99. Antoneta Gjeçi
100. Bujar Çakoni
101. Beta
102. Medicamenta
103. Philip Morris Albania
104. Konsort
105. Alumil - Albania
106. Porsche Albania
107. Helios Catering
108. GPA
109. AVON Cosmetics Albania
110. Eagle Mobile
111. Univers-Frigo D.A.R.B.
112. EGNATIA Group
113. Lauda Consulting
114. First Investment Bank
115. Stefani & Co
116. A & B Business Consulting
117. Fushe Kruja Cement Factory
118. Marin Barleti University
119. Yldon
120. ANAS
121. Energysolution
122. ACI Engineering
123. Intermed
124. Silvi Construction
125. Top Channel
126. Valu add Management Services
127. Printech Albania
128. Fastech
129. Alcatel - Lucent Italia
130. Bankers Petroleum Albania
131. Primagas Albania
132. Okjanus
133. Kla & Xhu
134. Mak Albania
135. Iris
136. InfoSoft Systems
137. Login Systems Albania
138. Studio Avokatie "Haxhia & Hajdari"
139. Intersig
140. Dajti Ekspres
141. Erbiron
142. TriMed
143. Eyes Advertising
144. Albania Partners Absorber
145. Austrian Airlines
146. American Noble Coffee
147. Korsel
148. DM Consulting Services Albania
149. Century 21 Albania
150. Microsoft Albania
151. NCH Advisors Inc.
152. Fondi i Pensioneve Vullnetare SIGAL
153. Alufloor Construction Group
154. Ast-Fa
155. BMI
156. ICTS Albania
157. Tonucci & Partners
158. N & N
159. Ermira Lulaj
160. AlbGarden
161. Trema Engineering 2
162. Wilo Adriatic
163. Balfin-Balkan Finance Investment Group
164. Express Albania
165. Century 21 The Point
166. Pelinku Jeans
167. Eurofast Global
168. Melgushi
169. Ernst & Young Certificated Auditors
170. Rivaldi Watches
171. Enternal
172. Stream Oil & gas Ltd. Albanian Branch
173. Europetrol Durrës Albania
174. Albanian Motor Company
175. JT Internacional Tirana
176. Gender Alliance for Development Center
177. Fejzo
178. Procredit Bank
179. Elton Daka
180. Chemonics International/Rritje Albania
181. MRDC
182. TPK Solutions
183. Belle Air
184. Landeslease
185. Tobacco Holdings Group
186. Easycom
187. Ksamili Investment
188. Nisatel
189. Albanian Duty Free Distribution
190. ANOSIS
191. Grant Thornton
192. Tea Construction & Petrol
193. Elledi
194. DAI-ACC
195. Albanian Airlines
196. Erident Company
197. Alb Juris
198. British American Tobacco Albania
199. Fusha
200. Rezar Llukaj
201. Albanian-American Development Foundation-AADF
202. Madison Avenue-Crown Club Albania
203. TGD Real Estate & Valuation Services
204. Avannive Consulting
205. Antea Cement

## Shtojcë 2

### AmCham në Shtyp

| Data      | Tema                                                                                                                                                      | Gazeta                                            | Stacione TV                                                                               |
|-----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------|
| 19 janar  | Forum Biznesi i Komitetit të Taksave dhe Ligjeve në AmCham mbi marrëdhëniet e biznesit me bankat, problematikat dhe informacioni që biznesi duhet të dijë | Shqip<br>Panorama                                 | TV Klan<br>Alsat<br>24 News                                                               |
| 8 mars    | Mëngjes Pune i Komitetit WoBAC me Ministren e Integritimit. Bashkëpunimi i grave në biznes dhe politikë                                                   | Panorama                                          | Alsat<br>Vizion Plus<br>Ora News                                                          |
| 13 mars   | Forum Biznesi, Komiteti i HR-it me Drejtorin e Informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve mbi listpagesat elektronike                        | Shqip<br>Panorama<br>Koha Jonë                    | Alsat<br>Ora News<br>Klan<br>ABC News<br>24 News<br>Vizion Plus<br>TVSH                   |
| 21 mars   | Forum Biznesi i Komitetit të HR-it me Autoritetin e Konkurrencës për çështjet e konkurrencës së bizneseve                                                 | Shqip<br>Metropol<br>Panorama<br>Koha Jonë        | Top Channel<br>TV Klan<br>24 News<br>TV Koha<br>Vizion Plus<br>Alsat<br>TVSH              |
| 25 prill  | Konferenca mbi çështjet e tregut të punës                                                                                                                 | Panorama<br>Standart<br>Koha Jonë<br>ATSH<br>TVSH | Top Channel<br>Klan<br>24 News<br>TV Koha<br>Vizion Plus<br>Ora News<br>Nesër TV<br>Alsat |
| 26 prill  | Panairi i Punës, Edicioni i 12 <sup>te</sup>                                                                                                              | Panorama<br>Metropol                              | A1<br>Ora news<br>Alsat                                                                   |
| 4 korrik  | Festimi i Ditës së Pavarësisë së Amerikës                                                                                                                 | Shqip<br>Standart<br>Metropol                     | TV Klan<br>Alsat<br>Ora News<br>A1                                                        |
| 25 korrik | Seminar për sistemin preferencial të eksporteve në Amerikë, Shqipëria është një ndër 128 vendet përfituese                                                | Gazeta Shqiptare<br>Shqip                         | Top Channel<br>Klan<br>24 News<br>Vizion Plus<br>Alsat<br>TV Koha                         |

|            |                                                                                         |                                                                                             |                                                                                                                     |
|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 12 shtator | Forum Biznesi i Dhomës Amerikane për çështjen e taksave e tatimeve. Deklaratë me median | Shqip<br>Metopol<br>Gazeta Shqiptare<br>Standart<br>Ballkan<br>Koha Jonë<br>Tirana Observer | Top Channel<br>Klan<br>24 News<br>Vizion Plus<br>Alsat<br>TV Koha<br>A1                                             |
| 23 tetor   | Forum Biznesi, Takim me Drejtorin e Doganave                                            | ATSH<br>Shqip<br>Panorama<br>Koha Jonë<br>Standart<br>Metropol                              | Top Channel<br>TV Klan<br>Alsat<br>TV Koha<br>TVSH<br>24 News<br>Ora News<br>Vizion Plus                            |
| 6 nëntor   | Election Night, Zgjedhjet Presidenciale në Amerikë                                      |                                                                                             | TV Koha<br>Vizion Plus<br>Klan<br>Top Channel<br>TVSH<br>Ora News<br>Alsat<br>Ora News<br>A1                        |
| 19 nëntor  | Lobimi për Gjykatën Administrative, Deklaratë e Dhomës Amerikane të Tregtisë            | Gazeta Tema<br>Shqip<br>Gazeta Shqiptare<br>Koha Jonë<br>Metropol<br>Tirana Observer        |                                                                                                                     |
| 20 nëntor  | Gjykata Administrative, Deklaratë e Përbashkët e tetë organizatave biznesi              | Shqip<br>Panorama<br>Gazeta Shqiptare<br>Koha Jonë<br>Tirana Observer                       |                                                                                                                     |
| 6 dhjetor  | Konferenca e Dytë e IPR-it                                                              |                                                                                             | Top Channel<br>TV Klan<br>24 News<br>Neser TV<br>TV Koha<br>TV Alsat<br>Ora News<br>ABC News<br>TVSH<br>Vizion Plus |
| 18 dhjetor | Forum Biznesi, Takim i Forumit të CEO-ve me kryeministrin Sali Berisha                  |                                                                                             | Top Channel<br>Klan<br>Tv Koha<br>Alsat<br>Vizion Plus<br>24 News<br>Ora News<br>ABC News<br>A1<br>Vizion Plus      |



### Sponsor të AmCham në Aktivitete dhe Publikime

Të radhitura sipas kontributit:

#### Boga & Associates

- Nata e Zgjedhjeve Amerikane 2012
- Mbrëmja e Fund Vitit

#### Microsoft Albania

- Konferenca e IPR-it
- Mbrëmja e Fund Vitit

#### Ande-LM

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës
- Mbrëmja e Fund Vitit

#### Albanian Duty Free Distribution

- Nata e Zgjedhjeve Amerikane 2012

#### Aldkris

- Mbrëmja e Fund Vitit

#### Europetrol Durres Albania

- Mbrëmja e Fund Vitit

#### Intermed

- Mbrëmja e Fund Vitit

#### USAID/Rritje Albania

- Konferenca për Çështjet e Tregut të Punës
- Konferenca e IPR-it

#### Aluflor Construction Group

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës
- Nata e Zgjedhjeve Amerikane 2012
- Mbrëmja e Fund Vitit

#### Kalo & Associates

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës
- Reklama në AmCham Advantage

#### Intersig Vienna Insurance Group

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

#### Erbiron

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës
- Nata e Zgjedhjeve Amerikane 2012

#### A & A Group

- Nata e Zgjedhjeve Amerikane 2012

#### Albanian American Enterprise Fund

- Nata e Zgjedhjeve Amerikane 2012

#### ABCom

- Konferenca e IPR-it 2012

#### Acromax

- Konferenca e IPR-it 2012

#### Bozo & Associates

- Nata e Zgjedhjeve Amerikane 2012

#### Unioni Financiar i Tiranës/Western Union

- Nata e Zgjedhjeve Amerikane 2012

#### PricewaterhouseCoopers Audit

- Nata e Zgjedhjeve Amerikane 2012

#### ZICO

- Nata e Zgjedhjeve Amerikane 2012

#### Sigal

- Reklama në AmCham Advantage

#### Ak-Invest

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

#### Grant Thornton

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

#### NCH Advisors

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

#### Philip Morris Albania

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

#### Stream Oil & Gas Ltd.

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

#### Tea Construction & Petrol

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

#### Coca Cola Bottling Shqipëria

- Reklama në AmCham Advantage

#### University of New York, Tirana

- Reklama në AmCham Advantage

## Sponsor të AmCham-it me produkte

### ALD-KRIS

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës
- Mbrëmja e Fund Vitit

### Birra Korça

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

### B & B Food Service/ Big Bite

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

### Coca-Cola Bottling Shqipëria

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

### Enternal/ Revista Psikostil

- Mbrëmja e Fund Vitit

### Ermira Lulaj

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

### Friends Distribution

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

### Kantina e Pijeve Gj. K. Skenderbeu

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës
- Mbrëmja e Fund Vitit

### Lauda Consulting/ EXILIR Floral Infusions

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës

### Miell Tirana

- Mbrëmja e Fund Vitit

### ZICO

- Festimet e Ditës së Pavarësisë së Amerikës
- Mbrëmja e Fund Vitit